



PPNEA

**RAPORT
VJETOR**

**20
24**

PPNEA

RAPORT VJETOR 2024



Fotografi: © PPNEA
Redaktore: Lorena Pyze Xhafaj
Menaxhere e Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Publikun

Sara Skrapalliu
Asistente e Komunikimit

Kristi Gjoni
Asistent i Komunikimit

Dizajn: Ermal Shenaj • Liaison Design

Të Drejtat e Autorit PPNEA

E themeluar në vitin 1991 si OJQ-ja e parë mjedisore në Shqipëri, PPNEA ka qenë një forcë pioniere në peizazhin mjedisor të vendit. Për më shumë se tre dekada, organizata është përkushtuar ndaj mbrojtjes së biodiversitetit unik të Shqipërisë, ruajtjes së jetës së egër, mbrojtjes së ekosistemeve kritike, avancimit të kërkimit shkencor, fuqizimit të komuniteteve lokale dhe promovimit të politikave më të forta mjedisore.



Vizioni Ynë

PPNEA punon për të sjellë harmoninë midis natyrës dhe shoqërisë njerëzore në Shqipëri. Ne besojmë në një botë ku institucionet e përgjegjshme dhe komuniteti angazhohen aktivisht në ruajtjen e natyrës dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.



Misioni Ynë

Misioni ynë është të sigurojmë një atmosferë shoqërore dhe qeverisëse ku ruajtja e natyrës është një prioritet, përmes kërkimeve shkencore rigorozë, angazhimit të komunitetit, krijimit të partneriteteve strategjike dhe ndërveprimit të vazhdueshëm me institucionet vendimmarrëse.

Fushat e Veprimit:

- Ruajtja e llojeve me rëndësi, të rrezikuar dhe të rrallë;
- Ruajtja e zonave me vlerë të lartë biodiversiteti;
- Kërkim shkencor mbi jetën e egër dhe habitatet;
- Edukim, ndërgjegjësim dhe advokim për çështjet e ruajtjes dhe mbrojtjes së natyrës;
- Zhvillimi institucional i Organizatave Mjedisore të Shoqërisë Civile.





Mesazh nga bordi i PPNEA-s

Parku Natyror i Alpeve të Shqipërisë

**Prof. Asc. Dr. Erjola Keçi**

Anëtare e Bordit të PPNEA-s

Përmes këtij mesazhi, dëshiroj të shpreh mirënjohjen time për secilin anëtar, partner, mbështetës, aktor të interesuar dhe vullnetar të PPNEA-s, për bashkëpunimin e përditshëm, përkushtimin dhe angazhimin, si dhe për rezultatet e rëndësishme të arritura së bashku, duke avancuar misionin tonë për ruajtjen dhe mbrojtjen e natyrës në Shqipëri, përmes kërkimeve shkencore rigorozë, angazhimit të komunitetit, krijimit të partneriteteve strategjike dhe ndërveprimit të vazhdueshëm me institucionet vendimmarrëse.

Ky raport vjetor është një moment reflektimi: ai shënon jo vetëm fillimin e presioneve të shtuara mbi zonat e mbrojtura të Shqipërisë, por edhe përgjegjësinë e vazhdueshme të shoqërisë civile, autoriteteve dhe qytetarëve për të mbrojtur këto ekosisteme të papërsëritshme.

Viti 2024 ka qenë një vit sfidues përse i përket mbrojtjes dhe ruajtjes së natyrës në Shqipëri.

Ai do të mbahet mend si viti kur vetë themelet e zonave tona të mbrojtura u testuan nga miratimi i një ligji të ri të kontestuar për Zonat e Mbrojtura – një ligj që u kundërshtua nga shumë ekspertë kombëtarë dhe ndërkombëtarë, dhe nga vetë Bashkimi Evropian. Ndërsa implikimet e tij kërcënonin dekada progresi, ai gjithashtu ringjalli një ndjenjë të thellë qëllimi brenda komunitetit tonë: të mbrojmë natyrën jo si një privilegj, por si një e drejtë dhe përgjegjësi.

Përgjatë vitit 2024, PPNEA u përball me realitetin e vështirë të dobësimit të mbrojtjes ligjore, por ekipet tona në terren nuk ndaluan kurrë monitorimin, restaurimin dhe mbrojtjen e biodiversitetit të Shqipërisë, nga shpendët folezues të ligatinave të ulëta deri te dhia e egër e luginave të larta.

PPNEA vazhdoi të flasë për lumenjtë, pyjet dhe llojet, e ardhmja e të cilëve varet nga veprimi i përbashkët.

Gjatë përvjetorit të 10-të të Procesit të Berlinit, PPNEA siguroi që çështjet mjedisore të mos injoroheshin në dialogun e gjërë politik, por të vendoseshin si qendrore për zhvillimin e ardhshëm të rajonit dhe integrimin e tij në BE.

Këtë vit, PPNEA ka kontribuar në zhvillimin e rekomandimeve të politikave të zbatueshme dhe në prezantimin e tyre për institucionet e BE-së dhe qeveritë e Ballkanit Perëndimor.

Përpykja e vazhdueshme për integritetin e Vjosë–Nartës tregoi se si qëndrueshmëria dhe shkenca mund të transformojnë ndërgjegjësimin publik në një lëvizje kombëtare, dhe madje ndërkombëtare. Pavarësisht pengesave, ky vit gjithashtu nxori në pah më të mirën e asaj që mund të arrijmë së bashku.











Çdo projekt, çdo ekspeditë, çdo partneritet u bë një akt i heshtur sfidues ndaj indiferencës, dhe një deklaratë që natyra ende ka rëndësi. Ky raport vjetor nuk është vetëm një regjistër aktivitetesh; është një kronikë e përkushtimit. Pas çdo imazhi, statistike dhe historie qëndron përpjekja e njerëzve që refuzuan të dorëzohen.








Çdo faqe e këtij raporti mban peshën e një viti vigilance, qëndrueshmërie dhe përpjekjeje të pandërprerë. PPNEA ka dëshmuar përkushtimin e vazhdueshëm për të mbrojtur mjedisin natyror në Shqipëri, përmes veprimeve të ruajtjes, kërkimit dhe monitorimit, zhvillimit të kapaciteteve, ndërgjegjësimit dhe promovimit, veprimeve ligjore dhe dialogut mbi politikat në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar.

Ruajtja e natyrës nuk është një rrugë e lehtë, veçanërisht në një peizazh ligjor dhe shoqëror në ndryshim, por mbetet një rrugë e domosdoshme.

Teksa shikojmë përpara, PPNEA qëndron e gatshme të vazhdojë këtë mision me vendosmëri të rinovuar. Sfidat e vitit 2024 na kujtojnë se e ardhmja e trashëgimisë natyrore të Shqipërisë varet nga uniteti, shkenca dhe guximi. Së bashku, do të sigurojmë që zërat e peizazheve, jetës së egër dhe komuniteteve tona jo vetëm të dëgjohen, por edhe të respektohen.

Fotografi Viti 2024







“

Falenderojmë të gjithë partnerët dhe bashkëpunëtorët tanë që kanë mbështetur dhe kontribuar në nismat tona për mbrojtjen dhe ruajtjen e mjedisit natyror në Shqipëri.

”

366 Ditë Vigilance, Shprese dhe Veprimi

Çdo faqe e këtij raporti tregon historinë e një viti të jetuar në terren, në zyra, në takime, në pyje, lumenj dhe qiell. 366 ditë vëzhgimi, pritjeje, veprimi dhe shprese. Gjatë vitit 2024 u përballëm me sfida që testuan çdo grimcë të përkushtimit tonë: ndryshime ligjore që kërcënonin zonat e mbrojtura, projekte infrastrukturore që kalonin nëpër ekosisteme jetësore dhe tensioni i vazhdueshëm midis zhvillimit dhe ruajtjes. Ne ngritëm alarmin, mobilizuam komunitetet, angazhuam autoritetet dhe i kujtuam botës se lumenjtë, pyjet dhe jeta e egër nuk mund të shprehen vetë. Ndërhyrja ndërkombëtare në projektin e Aeroportit të Vlorës solli një lehtësim, por gjithashtu na kujtoi se çdo fitore kërkon vigjilencë të palodhur.

Puna jonë përfshiu çdo detaj, nga më i vogli deri te më i madhi: drejtuam lejkëkët drejt foleve më të sigurta, numëruam lloje të sapolindur në bregdetin e Adriatikut, dokumentuam për herë të parë një turtull në Shqipëri, ndoqëm udhëtimet e ariut të murrme dhe të kalit të qyqes, dhe mbrojtëm korridoret ekologjike që u mundësojnë gjitarëve të mëdhenj – dhe shpresës – të lëvizin të lirë. Programi i Rimëkëmbjes së Rrëqebullit të Ballkanit qëndroi në zemër të përpjekjeve tona, duke na mësuar se durimi, këmbëngulja dhe bashkëpunimi janë vlerat e vërteta të ruajtjes së natyrës.

Përtej terrenit, u angazhuam për dijen, ndërgjegjësimin dhe për një të ardhme ku qeverisja mjedisore ka rëndësi. Trajnuam, krijuam partneritete, fuqizuam të rinjtë dhe kontribuam në Agjendën e Gjellbër në gjithë Ballkanin Perëndimor, duke siguruar që politikat, buxhetet dhe veprimet të reflektojnë nevojën urgjente për peizazhe të qëndrueshme ndaj ndryshimeve klimatike dhe të pasura me biodiversitet.

Ky raport është më shumë se shifra, politika apo ngjarje kryesore; ai është një kronikë përkushtimi. Çdo paragraf pasqyron orët e kaluara në shi, në diell, në male dhe në sallat e takimeve; çdo pikë të dhënash lidhet me një bisedë, një komunitet, një shpend, një gjurmë, një lumë apo një pemë. Dhe mes gjithçkaje, kemi pasur mbështetjen e partnerëve, donatorëve, vullnetarëve dhe komuniteteve lokale.

Nëse ky raport tregon një histori, është kjo: ruajtja e natyrës nuk është vetëm punë; është një përkushtim i zemrës, mendjes dhe shpirtit, që vazhdon ditë pas dite, sepse bota që ne mbrojmë ia vlen çdo sekondë.

Gjatë vitit 2024, PPNEA vijoi misionin për të mbrojtur biodiversitetin unik të Shqipërisë, duke udhëhequr çdo projekt përmes shkencës, angazhimit të komunitetit dhe advokimit.

Programi për Rimëkëmbjen e Rrëqebullit të Ballkanit 2.0

Kohëzgjatja: 01.09.2022 – 31.12.2027

• —————

Pyje përtej Kufijve

Kohëzgjatja: 01.06.2022 – 31.12.2024

• —————

“Mbrojtja e grykëderdhjes së Vjosës nga zhvillimi urban i paqëndrueshëm: një qasje e integruar për ruajtjen afatgjatë të vlerave të biodiversitetit në luginën e poshtme të Vjosës”

Kohëzgjatja: 01.01.2022 – 01.12.2024

• —————

Korridore të Sigurta të Fluturimit IKB 3

Kohëzgjatja: 01.01.2024 – 31.12.2025

• —————

Studim fizibiliteti për përmirësimin e ruajtjes së lidhshmërisë ekologjike në Rajonin e Fokusuar të PONT-it: Shqipëri

Kohëzgjatja: 18.03.2024 – 25.06.2024

• —————

Foka e Mesdheut e Adriatikut Lindor

Kohëzgjatja: 01.04.2021 – 31.03.2024

• —————

Shtegu i Ballkanit: Dy hapa drejt të tjerëve

Kohëzgjatja: 01.11.2023 – 31.10.2024

• —————

BalkanDetox Life

Kohëzgjatja: 01.10.2020 – 30.09.2025

• —————

Nisma e Pyjeve Veriore: Restaurimi i pyjeve në Maqedoninë e Veriut dhe Shqipëri

Kohëzgjatja: 21.06.2023 – 31.05.2025

• —————

Përmirësimi i statusit të lundërzës dhe habitatit të këtij lloji në zonën ndërkufitare të Parkut Kombëtar të Liqenit të Shkodrës

Kohëzgjatja: 01.10.2024 – 30.09.2025

• —————

Ruajtja Ndërkufitare e Ariut të Murrme në

Jugperëndim të Ballkanit (TBBC)

Kohëzgjatja: 01.07.2024 – 30.06.2026

• —————

We go Coop

Kohëzgjatja: 01.01.2024 – 31.03.2026

• —————

Hapja e rrugës drejt zbatimit të korridoreve ekologjike në Shqipëri përmes përmirësimit të qeverisjes dhe menaxhimit të Zonave të Mbrojtura

Kohëzgjatja: 01.02.2023 – 31.01.2026

• —————

Foka e Mesdheut e Adriatikut

Kohëzgjatja: 01.04.2024 – 31.03.2027

• —————

Projekti i Prespës – Ruajtja e Biodiversitetit në

Prespën Ndërkufitare (Euronatur)

Kohëzgjatja: 01.03.2024 – 28.02.2027

• —————

Naviguesi i Agjendës së Gjellbër – Fuqizimi i shoqërisë civile për të mbështetur zhvillimin e ekonomive neutrale dhe të qëndrueshme ndaj ndryshimeve klimatike në Ballkanin Perëndimor

Kohëzgjatja: 01.12.2024 – 31.05.2027

• —————

4PETHABECO

Kohëzgjatja: 01.09.2024 – 31.08.2027

• —————

Projekti i Prespës – Mbrojtja e ujërave dhe jetës së egër në Rajonin Ekologjik Prespë–Ohër–Shebenik përmes Angazhimit të Komunitetit

Kohëzgjatja: 01.02.2024 – 31.01.2027

Qasja jonë



Martin Peshkatari (*Alcedo atthis*)



Shkenca & monitorimi

Ne mbështetemi në monitorimin në terren për të udhëhequr çdo veprim, nga vendosja e kamerave për të kapur rrëqebullin e Ballkanit, të rrezikuar në mënyrë kritike, deri te vëzhgimi i popullatave të peshqve dhe shpendëve në lumenj e ligatina. Ruajtja dhe mbrojtja e bazuar në të dhëna siguron besueshmëri dhe ndikim të matshëm.



Angazhimi i komunitetit

Ne besojmë se ruajtja e natyrës nuk mund të ketë sukses pa njerëzit. Nga aksionet e pyllëzimit dhe kampet e ruajtjes, te programet shkollore dhe festivalet, kemi angazhuar mijëra qytetarë në mbrojtjen e trashëgimisë së tyre natyrore.



Politika & advokimi

Natyra ka nevojë për një zë në tryezën e vendimmarrjes. PPNEA ka kontribuar në strategji kombëtare, raporte të BE-së dhe dialogë rajonalë, duke siguruar që prioritetet e konservimit të integrohen në zhvillimin e Shqipërisë.



Kreativiteti & ndërgjegjësimi

Nga ekspozitat te muralet, dokumentarët dhe fushatat në rrjetet e komunikimit, ne përcollëm kreativitetin për t'i afruar natyrën shoqërisë dhe për të frymëzuar një brez të ri mbrojtësish të natyrës.



Rezultatet:

- Lloje kritikisht të rrezikuar dhe të mbrojtur;
- Habitata kyçe të monitoruara dhe të restauruara: pyje, lumenj, ligatina;
- Angazhimi i komunitetit dhe të rinjve: mbi 1,000 qytetarë dhe studentë të përfshirë;
- Ndikim në politika: Kontribute në strategji, ligje dhe raporte kombëtare dhe rajonale;
- Njohje ndërkombëtare: Prezantime në media globale dhe pjesëmarrje në rrjete ekspertësh.

TABELA E PËRMBAJTJES

KAPITULLI 1

Për natyrën në Samitin e Procesit të Berlinit 2024

Si PPNEA solli biodiversitetin në
agjendën rajonale

fq.
16

KAPITULLI 2

Ndaloni Aeroportin në Vjosë-Nartë

Beteja për grykëderdhjen e lumit
të fundit të egër të Europës

fq.
20

KAPITULLI 3

#NatureLynxUs

Shkenca, arti, të rinjtë dhe
komuniteti, të bashkuar për
rreqebullin e Ballkanit

fq.
28

KAPITULLI 4

#PrespaNet

Bashkëpunim ndërkufitar për
ligatinat, jetën e egër dhe njerëzit

fq.
38

KAPITULLI 5

Në natyrë

Punë në terren, zbulime dhe
mbrojtja e biodiversitetit unik
të Shqipërisë

fq.
46

KAPITULLI 6

Ndërlidhja e peizazheve

Ruajtja e Korridoreve Ekologjike
në Shqipëri

**P.
50**

KAPITULLI 7

Natyra ka nevojë për një zë

Nisma për ruajtjen e natyrës

**fq.
56**

KAPITULLI 8

Bashkëpunohet, Mbështet dhe Përfshihet

Komunikimi dhe financa

**fq.
74**

KAPITULLI 9

Të tjera...

Historitë dhe momentet
kryesore nga terreni,
kërkimi shkencor.

**fq.
80**

KAPITULLI 10

Çfarë mbart e nesërmja

**fq.
96**



KAPITULLI

1

**PËR NATYRËN
NË SAMITIN E
PROCESIT TË
BERLINIT 2024**



Përvjetori i 10-të i Procesit të Berlinit ishte një ngjarje kyçe, që shënoi një dekadë për avancimin e bashkëpunimit dhe integritimit midis Ballkanit Perëndimor dhe Bashkimit Evropian. Ky samit, një moment vendimtar në rrugëtimin e rajonit drejt BE-së, u përqendrua në adresimin e sfidave kryesore, si qeverisja mjedisore, zhvillimi i qëndrueshëm dhe sundimi i ligjit. Një platformë e rëndësishme për shoqërinë civile, qeveritë dhe partnerët ndërkombëtarë, për të marrë pjesë në dialog dhe për të promovuar reforma që përputhen me standardet e BE-së.

Në Forumin e Shoqërisë Civile dhe Think Tank 2024, i mbajtur në kuadër të samitit, morën pjesë mbi 115 organizata që kontribuan në formësimin e së ardhmes së qëndrueshme të rajonit. Ky forum ofroi një hapësirë të paçmuar ku aktorët e shoqërisë civile mund të propozonin zgjidhje konkrete për sfidat me të cilat përballen vendet e Ballkanit Perëndimor. Forumi i këtij viti përfshiu shtatë grupe pune tematike, ku PPNEA shërbeu si raportues për Grupin e Punës F, i përqendruar në “Mbrotjtjen e Mjedisit dhe Zhvillimin Ekonomik të Qëndrueshëm.”

1.1 Roli Kryesor i PPNEA-së si raportues për Grupin e Punës F

Si raportues për Grupin e Punës F, PPNEA luajti një rol udhëheqës në drejtimin e diskutimeve dhe në lehtësimin e zhvillimit të rekomandimeve për përmirësimin e qeverisjes mjedisore dhe sigurimin e zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm në Ballkanin Perëndimor. Pjesëmarrja e PPNEA-s në forum ishte thelbësore për të siguruar që prioritetet mjedisore të rajonit të përfaqësoheshin dhe dëgjoheshin nga aktorët kryesorë, përfshirë liderët e BE-së dhe qeveritë e Ballkanit Perëndimor.

Në këtë kapacitet, PPNEA kontribuoi në formësimin e rekomandimeve kryesore të politikave në fusha kritike për zhvillimin e ardhshëm të rajonit:

1. Forcimi i sundimit të ligjit në vendimmarrjen mjedisore: PPNEA theksoi nevojën për kuadro ligjore më të forta dhe mekanizma më efektivë zbatimi për të siguruar që ligjet mjedisore respektohen dhe zbatohen. Mungesa e zbatimit ka çuar shpesh në degradim mjedisor, dhe PPNEA advokoi për një llogaridhënie më të mirë institucionale për ta adresuar këtë çështje.
2. Promovimi i bashkëpunimit rajonal mjedisor:

Si pjesë e rolit të saj në forum, PPNEA nxiti më shumë bashkëpunim midis vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe BE-së mbi çështje si ruajtja e biodiversitetit, zbutja e ndryshimeve klimatike dhe menaxhimi i burimeve natyrore ndërkufitare. Ky rekomandim thekson se vetëm përmes përpjekjeve të përbashkëta mund të trajtohen sfidat mjedisore të rajonit.

3. Nxitja e praktikave ekonomike të qëndrueshme: PPNEA advokoi gjithashtu për integrimin e qëndrueshmërisë në strategjitë e zhvillimit ekonomik, duke përfshirë promovimin e investimeve të gjelbra, mbështetjen e bujqësisë së qëndrueshme dhe zhvillimin e projekteve të energjisë së ripërtëritshme jashtë zonave me biodiversitet të rëndësishëm.

Duke prezantuar këto rekomandime, PPNEA siguroi që prioritetet mjedisore të Ballkanit Perëndimor të trajtoheshin direkt në nivelin më të lartë politik, duke i inkurajuar liderët e BE-së dhe liderët rajonalë të ndërmarrin veprime të menjëhershme dhe afatgjata për të mbrojtur mjedisin dhe për të siguruar rritje të qëndrueshme në rajon.



© Instituti Aspen i Gjermanisë / Shoqata e Evropës Juglindore

1.2 Rekomandimet e politikave të prezantuara në Samitin e Procesit të Berlinit

Në Samitin për Përvjetorin e 10-të të Procesit të Berlinit, rekomandimet e politikave të zhvilluara nga Grupi i Punës F u prezantuan për liderët e BE-së dhe qeveritë e Ballkanit Perëndimor. Këto rekomandime, të bazuara në diskutime të thella dhe njohuri ekspertësh, synonin avancimin e mbrojtjes së mjedisit dhe zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm në Ballkanin Perëndimor, duke forcuar sundimin e ligjit në qeverisjen mjedisore.

Duke prezantuar këto rekomandime, PPNEA siguroi që prioritetet mjedisore të rajonit të trajtoheshin direkt në nivelin më të lartë politik, duke i inkurajuar liderët e BE-së dhe rajonalë, të ndërmarrin veprime të menjëhershme dhe afatgjata për të mbrojtur mjedisin dhe për të siguruar një rritje të qëndrueshme në rajon.

1.3 Ndikimi i kontributeve të PPNEA-s

Pjesëmarrja aktive e PPNEA-s në Forumin e Shoqërisë Civile dhe Think Tank 2024, si dhe roli i saj si raportues për Grupin e Punës F, nënvizuan udhëheqjen e organizatës në advokimin për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm në Ballkanin Perëndimor.

Përmes këtyre përpjekjeve, PPNEA siguroi që çështjet mjedisore të mos marginalizoheshin në dialogun politik më të gjerë, por të vendoseshin në qendër të diskutimeve për zhvillimin e ardhshëm të rajonit dhe integrimin e tij në BE. Ky angazhim i dha PPNEA-s një mundësi unike për të amplifikuar zërin e shoqërisë civile dhe për të ndikuar drejtpërdrejt në procesin e politikëbërjes në nivel të lartë.

Duke kontribuar në zhvillimin e rekomandimeve konkrete të politikave dhe duke i prezantuar ato institucion-

eve të BE-së dhe qeverive të Ballkanit Perëndimor, PPNEA forcoi angazhimin e saj për promovimin e qëndrueshmërisë mjedisore dhe të qeverisjes së mirë në rajon. Ky punim pritet të jetë vendimtar në formësimin e procesit të pranimi të Ballkanit Perëndimor në BE dhe në sigurimin që sfidat mjedisore të adresohen në një mënyrë që sjell përfitime si për rajonin, ashtu edhe për komunitetin më të gjerë evropian.

Përmes angazhimit të saj në Procesin e Berlinit, PPNEA tregoi rolin e saj kritik si kampione e qeverisjes mjedisore, duke siguruar që prioritetet mjedisore të rajonit të vendosen në qendër të agjendës së integritimit në BE dhe duke kontribuar në ndërtimin e një të ardhmeje të qëndrueshme e të respektueshme nga ligji për Ballkanin Perëndimor.



© Stefan Samandov

Më shumë

Forum i Shoqërisë Civile dhe Think Tank 2024, i mbajtur në kuadër të Procesit të Berlinit, ofroi një platformë jetike për mbi 115 organizata të shoqërisë civile dhe qendrave hulumtuese nga Ballkani Perëndimor për të marrë pjesë në dialog me vendim-marrësit nga BE-ja dhe rajoni. Ky forum u organizua nga Shoqata e Evropës Juglindore dhe Instituti Aspen i Gjermanisë, me mbështetje nga Zyra Federale Gjermane për Çështjet e Jashtme, duke siguruar një pjesëmarrje të gjerë dhe me ndikim në këto diskutime.

KAPITULLI

2

NDALONI AEROPORTIN NË VJOSË - NARTË

Mbrojtja e Grykëderdhjes së Vjosës nga zhvillimi i paqëndrueshëm urban:

Një qasje e integruar për ruajtjen afatgjatë të vlerave të biodiversitetit në luginën e poshtme të Vjosës



Vendndodhja:
Peizazhi i Mbrojtur Vjosë–Nartë



Kohëzgjatja:
3 vite



Partnerë Projekti:
EuroNatur



Donator Projekti:
DIMFE

QËLLIMET STRATEGJIKE

- Krijimi i një baze të dhënash dhe informacioni për grykëderdhjen e Vjosës.
- Lobim dhe advokim në nivele kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare për mbrojtjen e Peizazhit të Mbrojtur Vjosë–Nartë, një ligatinë me rëndësi ndërkombëtare, nga planet e paqëndrueshme infrastrukturore brenda zonës së mbrojtur.
- Rritja e ndërgjegjësimit publik mbi vlerën e lartë të biodiversitetit të zonës dhe kërcënimet që e rrezikojnë atë.
- Ruajtja dhe restaurimi i popullatave të shpendëve dhe habitateve të tyre.

Peizazhi i Mbrojtur Vjosë - Nartë

2.1 Një betejë për Zonat e Mbrojtura në Shqipëri

Vjosë–Narta dhe ekosistemi përreth përfaqësojnë një nga ligatinat më të mëdha dhe më të rëndësishme të Shqipërisë dhe Mesdheut. Përveçse është pjesë e Rrjetit të Zonave të Mbrojtura të Shqipërisë, Vjosë–Narta përfshihet pothuajse në të gjitha rrjetet ekologjike ndërkombëtare ku një vend natyror i Shqipërisë mund të bëjë pjesë.


Kjo ligatinë njihet si Zonë e Rëndësishme për Shpendët (IBA), Zonë Kyçe e Biodiversitetit (KBA) dhe është propozuar zyrtarisht nga qeveria shqiptare si vend kandidat për Rrjetin Emerald. Për më tepër, ajo është pjesë e ekosistemit të ujërave të ëmbla të grykëderdhjes së Vjosës, një nga më të rëndësishmet e Adriatikut.

Habitati i saj i larmishëm që përfshin duna rëre, laguna, kripore, grykëderdhje dhe vijë detare, e bën këtë zonë një strehë ideale për një shumëllojshmëri të pasur flore dhe faune me rëndësi, përfshirë pelikanin kaçurrel, bretkosën shqiptare të ujit (endemike), breshkën e detit dhe fokën e Mesdheut, etj. Vjosë–Narta është gjithashtu një ndalesë e rëndësishme për shpendët shtegtarë, një shtëpi

për jetën e egër të detit dhe një vend me vlera natyrore të jashtëzakonshme.

Megjithëse Vjosa–Narta ka një rëndësi të vyer, ndërtimi i Aeroportit Ndërkombëtar të Vlorës dhe ndërtimi potencial i resorteve turistike brenda kufijve të kësaj zone të mbrojtur rrezikojnë seriozisht integritetin e saj ekologjik. Këto kërcënime mund të sjellin humbje dhe fragmentim të habitatëve, dëmtime të jetës së egër dhe forma të ndryshme ndotjeje, përfshirë ndotjen nga ndriçimi, zhurma dhe uji i ndotur.

Një grup i përkushtuar individësh dhe organizatash po punon për të mbrojtur lagunën e Vjosë–Nartës nga pasojat e dëmshme të këtij ndërtimi. Këto përpjekje zhvillohen në disa nivele: përmes kërkimit shkencor, ndërgjegjësimit publik, lobimit, përfshirjes së komunitetit dhe advokimit. PPNEA, në bashkëpunim të ngushtë me EuroNatur, ka ndërmarrë hapa të mëdhenj për të mbështetur këtë çështje dhe për të siguruar zbatimin e projektit.



Grykëderdhja e Lumit Vjosa

2.2 Investigimet shkencore

Mbledhja dhe analiza e të dhënave shkencore ishin një komponent thelbësor i projektit. U zhvilluan rregullisht aktivitete monitorimi, përfshirë:

- Monitorimin e shpendëve folezues;
- Censusin ndërkombëtar të shpendëve ujorë;
- Numërimin e shpendëve shtegtar (i realizuar me sukses në vitet 2023 dhe 2024);
- Censusin e Pelikanit kaçurrel;
- Monitorimin e çakallit.

Gjithashtu, u instaluan me sukses dy transmetues satelitor GPS në lloje si pelikani kaçurrel dhe kojliku i madh. U realizua gjithashtu unazimi i llojeve të synuara (Vrapuesi i vogël, sqepbiza, common tern, little tern dhe pelikani kaçurrel) në bashkëpunim me ekspertë ndërkombëtarë.

Këto përpjekje monitorimi ndihmuan në dokumentimin e biodiversitetit dhe mbështetën strategjitë e menaxhimit për ruajtjen e tij. Ato kontribuan gjithashtu në mbrojtjen e vendeve të folezimit të breshkave të detit dhe në restaurimin e pyjeve të degraduara përmes mbjelljes së pishave. Aktivitetet shkencore të monitorimit vazhduan gjatë gjithë vitit 2024.

2.3 Nisma ligjore dhe advokuese

Përveç përpjekjeve shkencore, u ndërmorën veprime ligjore, si kundër Rishikimit të Zonës së Mbrojtur, ashtu edhe kundër Kontratës së Aeroportit. Gjatë vitit 2023, proceset gjyqësore shënuan arritje të rëndësishme, ndërsa në vitin 2024 përparimi u ngadalësua ku u zhvilluan vetëm seanca procedurale.

Advokimi mbeti një komponent kyç i projektit dhe u realizua përmes:

- Lobimit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, duke përfshirë OJQ-të shqiptare, deputetë të Kuvendit, Konventën e Bernës, institucionet e BE-së, AEWA, BirdLife Europe & Central Asia dhe misionet diplomatike;
- Takimeve strategjike në Bruksel dhe Strasburg, përfshirë pjesëmarrjen në eventin e 10-vjetorit të CEPF dhe

në mbledhjen e Komitetit të Përhershëm të Konventës së Bernës;

- Krijimit të partneriteteve me Aleancën Mesdhetare për Ligatinat dhe BirdLife Europe & Central Asia, duke zgjeruar rrjetin dhe ndikimin e projektit.

Gjatë vitit 2024, përpjekjet vazhduan përmes takimeve me përfaqësues të BE-së në Shqipëri, Konventën e Bernës, AEWA, OJQ-të dhe media. Fushata e vazhdueshme me Aleancën e Mesdheut për Ligatinat, përmes mekanizmit Red Alert, mbeti një mjet kyç advokimi. Përmes këtyre aktiviteteve, projekti kontribuoi edhe në kundërshtimin e ligjit të ri për Zonat e Mbrojtura, i cili parashikon pasoja negative për zona të rëndësishme si Vjosë-Narta dhe Parku Kombëtar Detar Karaburun-Sazan.



Deklaratë publike në Kuvendin e Shqipërisë

2.4 Ndërgjegjësimi publik dhe aktivitetet

Rritja e ndërgjegjësitimit publik ishte një nga objektivat kryesore të projektit. Fushata “**Ndaloni Aeroportin në Vjosë-Nartë**” u shndërrua në platformën kryesore për komunikimin me publikun:

- U organizua një konferencë dyditore në Tiranë dhe Vlorë, që bashkoi ekspertë, OJQ dhe gazetarë për të ndarë gjetjet dhe për të diskutuar ndërtimin e aeroportit;
- U zhvilluan protesta publike në Vlorë dhe Tiranë;
- Mbi 2000 individë morën pjesë në aktivitetet e lidhura me projektin.

- Dy dokumentarë (“Ndaloni Aeroportin” dhe L’aéroport de Vlora) dhe dhjetëra raportime mediatike arritën rreth 1 milion njerëz.

- Iniciativat edukative përfshinë sesione edukimi mjedisor, një kamp veror dhe nisma pyllëzimi.

- Aktivitetet e ndërgjegjësitimit publik dhe promovimit vazhduan edhe gjatë vitit 2024, duke synuar përfshirjen e një spektri më të gjerë aktorësh të interesuar.

2.5 Ndikimet kryesore të projektit

- **Rritje e ndërgjegjësimit** për rëndësinë e ekosistemit të ujërave të ëmbla, në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar.
- **Përmirësim i ruajtjes** së biodiversitetit përmes monitorimit shkencor dhe ndërhyrjeve të drejtpërdrejta, të mbështetura nga teknologji të reja.
- **Fuqizim i advokimit** kundër ndërtimit të aeroportit, duke mobilizuar mbështetje publike dhe duke ndikuar në proceset vendimmarrëse.
- **Përfshirje dhe fuqizim i aktorëve lokalë**, përfshirë komunitetet, stafin e zonave të mbrojtura dhe organizatat e shoqërisë civile, në aktivitete të ruajtjes dhe advokimit.
- **Rritje e kapaciteteve institucionale të PPNEA-s**, përfshirë anëtarësimin në dy rrjete ndërkombëtare kyçe: BirdLife International dhe Aleancën e Mesdheut për Ligatinat.



Shkolla Verore e Nartës, 2024 në Peizazhin e Mbrojtur Vjosë – Nartë

2.6 Studentët e BirdON marrin pjesë aktive në Vjosa-Nartë

Studentët e BirdON, së bashku me vullnetarët e PPNEA-s dhe Administratën e Zonave të Mbrojtura Vlorë, mbollën rreth 200 fidanë pishe në Zonën e Mbrojtur Vjosa-Nartë. Ky aktivitet praktik ndërthuri restaurimin e habitatit me edukimin mjedisor, ndërgjegjësim mbi vlerat natyrore dhe duke përfshirë të rinjtë në mbrojtjen e natyrës.



Aksion pyllëzimi me shkollat lokale në Pishë Poro

2.7 Zbulimi i biodiversitetit të Lagunës së Nartës

Pjesëmarrësit eksploruan Lagunën e Nartës, duke vëzhguar lloje ikonike si Flamingo, Pelikani kaçurrel, Bilbili i ujit, Karabullaku i madh etj.. Përmes sesioneve të përcaktuara, nxënësit thelluan njohuritë e tyre mbi rëndësinë ekologjike të lagunës dhe kërcënimet që paraqesin projekte të tilla si Aeroporti i Vlorës.

2.8 Angazhimi i gjeneratës së re

Aktivitetet edukative u zhvilluan edhe në shkollën “Kalif Malaj” në Bishan, ku nxënësit mësuan rreth biodiversitetit të pasur të Shqipërisë dhe nevojës jetike për ta mbrojtur atë.



Flamingo, *Phoenicopaterus roseus*



Manifestim kundër ligjit të ri për Zonat e Mbrojtura, nr. 21/2024


2.9 Aeroporti Ndërkombëtar i Vlorës pengon rrugën e shtegimit të pelikanit kaçurrel

Aeroporti Ndërkombëtar i Vlorës është vendosur midis dy prej sistemeve më të rëndësishme ligatinore në Shqipëri, Lagunës së Nartës dhe Lagunës së Karavastës. Çdo ditë, qindra shpendë kalojnë nëpër këtë korridor biologjik, duke u ngritur dhe ulur për t'u ushqyer, për t'u riprodhuar dhe për të ndaluar gjatë shtegimit, në udhëtime që shtrihen nga distanca të shkurtra deri në ato shumë të gjata. Megjithatë, rruga e shtegimit të shpendëve do të pengohet për shkak të vendndodhjes së papërshtatshme të Aeroportit Ndërkombëtar të Vlorës brenda Zonës së Mbrojtur Vjosë-Nartë, i cili njëkohësisht krijon rrezik të shtuar edhe për sigurinë e qytetarëve që do ta përdorin atë.

Me afrimin e sezonit të riprodhimit, kolonia e pelikanit kaçurrel – e vetmja në Shqipëri – ka nisur të mbledhet në Lagunën e Karavastës. Mes tufave që lëvizin ndërmjet ligatinave të vendit ndodhet edhe një pelikan i pajisur rishtazi me transmetues satelitor GPS.

Ky pelikan kaçurrel, një nga shpendët më të mëdhenj në botë dhe simbol kombëtar, përmes fluturimeve të tij tregon qartë ndërprerjen e këtij korridori shtegimi dhe rrezikun real të përplasjes me avionët në të ardhmen.

Studimet e fundit, të realizuara përmes transmetuesve satelitorë për lloje me rëndësi kombëtare dhe ndërkombëtare në Zonën e Mbrojtur Vjosë-Nartë, kanë dokumentuar lëvizjet e përditshme të shpendëve mbi zonën e ndërtimit të Aeroportit Ndërkombëtar të Vlorës. Këto të dhëna tregojnë se vendimmarrja dhe vlerësimet paraprake mbi të cilat u mbështet ky projekt kanë qenë të pasakta dhe rrezikojnë të sjellin pasoja serioze për natyrën.



Pelikani kaçurrel duke fluturuar mbi ndërtimin e pistës së Aeroportit Ndërkombëtar të Vlorës.



Forume Mjedisore për mbrojtjen e Zonave të Mbrojtura

2.10 Vjosë-Nartë: Advokimi për lumin e egër të Europës

Rasti i Vjosë-Nartës u diskutua gjerësisht në mbledhjen e Komitetit të Përhershëm të Konventës së Bernës në Strasburg, e cila përfundoi më 6 dhjetor. Diskutimet u fokusuan në ndikimet e mundshme mjedisore të projekteve përgjatë lumit Vjosa, përfshirë projektet hidroenergjetike dhe ndërtimin e Aeroportit Ndërkombëtar të Vlorës.

Edhe pse Konventa e Bernës ka rekomanduar pezullimin e punimeve deri në përfundimin e një vlerësimi të plotë të ndikimit në mjedis, punimet për aeroportin vazhdojnë.

Të dhënat më të fundit tregojnë pasoja shqetësuese:

- Humbje e biodiversitetit;
- Rreziqe për jetën e egër: lloje të pajisur me transmetues satelitor GPS, përfshirë Pelikanin kaçurrel dhe Hutën bishtgërshërë të kuqërreme, janë vëzhguar duke fluturuar mbi zonën e aeroportit, duke kundërshtuar vlerësimet e mëparshme mjedisore;
- Kufizim i monitorimit: ekspertëve të PPNEA-s u është penguar kryerja regjistrimit ndërkombëtar të shpendëve të ujit në muajin janar.



Zonë qëndrimi dhe pushimi për Pelikanin kaçurrel dhe Karabullakun e madh, më pak se 3km larg punimeve të ndërtimit të Aeroportit Ndërkombëtar të Vlorës

Kërcënime të tjera burojnë nga ndryshimet legjislative që lejojnë ndërtimin e projekteve të mëdha infrastrukturore brenda Zonave të Mbrojtura, duke vënë në rrezik ekosistemin e Vjosë–Nartës dhe të gjithë rrjetin e Zonave të Mbrojtura në Shqipëri. Lumi përballet gjithashtu me presione nga projektet e propozuara për devijim, të cilat mund të ulin prurjen e ujit dhe të komprometojnë integritetin ekologjik.

PPNEA dhe partnerët e saj i kërkuan Komitetit të Përhershëm të Konventës së Bernës që:

1. Të riafirmojë pezullimin e ndërtimit të Aeroportit të Vlorës.
 2. Të kryejë një vlerësim në terren për projektin e devijimit të Shushicës.
 1. Të nxisë autoritetet shqiptare të tërheqin ndryshimet ligjore që rrezikojnë Zonat e Mbrojtura dhe rrjetin Emerald.
- Ky është një moment kritik për mbrojtjen e Vjosë–Nartës dhe të trashëgimisë natyrore të Shqipërisë.



Zona e Mbrojtur Vjosë – Nartë

2.11

Sikur të ishte fotografia e fundit

Laguna e Nartës, me qiellin e saj të gjerë dhe ujërat që shkëlqejnë, mbetet një ndalesë thelbësore për mijëra shpendë shtegtarë që kalojnë nëpër korridorin Vjosë–Nartë. Për vitin e dytë radhazi, PPNEA, së bashku me ekspertë rajonalë, ka monitoruar me kujdes këto lëvizje, duke dokumentuar jo vetëm bukurinë e shtegtimin, por edhe kërcënimet që e rrezikojnë atë.

Gjatë monitorimit, u regjistruan lloje si Shqipja e kënetës, Skifteri i drurëve, Skifteri këmbëkuq dhe Lajmëtari i madh i furtunës, të gjithë pjesë e një ekuilibri të brishtë që varet nga habitatet e sigurta dhe të paprekura.

Megjithatë, peizazhi që i mirëpret këta shpendë ndodhet nën kërcënim të vazhdueshëm, për shkak të planeve për ndërtimin e aeroportit dhe projekteve luksoze që rrezikojnë rrugët e tyre shekullore të shtegtimin. Çdo fotografi që kapim është më shumë se një dokumentim; është një kujtesë e asaj që mund të humbasim nëse këto ndërhyrje vazhdojnë. Ne ende kemi shpresë që këto imazhe nuk do të shndërrohen në “fotografinë e fundit” të një shtegtimi që po zhduket.

KAPITULLI

3

PROGRAMI I RIMËKËMBJES SË RRËQEBULLIT TË BALLKANIT, FAZA VII



Vendndodhja: Në pjesën jugperëndimore të Gadishullit të Ballkanit, brenda zonës aktuale të shpërndarjes që përfshin Shqipërinë, Maqedoninë e Veriut dhe Kosovën.



Partnerët e projektit: Organizata për Ruajtjen dhe Mbrojtjen e Mjedisit Natyror në Shqipëri (PPNEA) me qendër në Shqipëri; Shoqata Ekologjike e Maqedonisë (MES) me qendër në Maqedoninë e Veriut; Grupi për Veprim të Përgjegjshëm Mjedisor (ERA) me qendër në Kosovë; Fondacioni Euronatur me qendër në Gjermani; dhe Fondacioni KORA me qendër në Zvicër.



Kohëzgjatja e projektit, faza VII: Shtator 2022 – Dhjetor 2027.



BALKAN LYNX

RECOVERY
PROGRAMME


3.1

Programi i Rimëkëmbjes së Rrëqebullit të Ballkanit, Faza VII

PPNEA ka punuar për 20 vite në mbrojtjen e rrëqebullit të Ballkanit dhe në mbështetjen e rimëkëmbjes së tij, si në nivel kombëtar ashtu edhe ndërkufitar. Qëllimi i programit është të sigurojë një popullatë të qëndrueshme të rrëqebullit të Ballkanit, që të bashkëjetojë në harmoni me komunitetet lokale. Përmeshja e këtij vizioni synohet të arrihet përmes qëllimit kryesor të programit, sipas të cilit pritet që ky lloj të ulet në kategorinë “I rrezikuar” në Listën e Kuqe të IUCN. Ky ndryshim pozitiv do të realizohet falë rritjes së diversitetit gjenetik, bazës së qëndrueshme të presë, ndërlidhjes efektive të habitateve, si dhe uljes së ndjeshme të kërcënimeve të shkaktuara nga njeriu.

Programi i Rimëkëmbjes së rrëqebullit të Ballkanit është një nismë ndërkufitare që ka nisur në vitin 2006 dhe vazhdon ende. Që prej themelimit, programi është përqendruar në mbrojtjen e popullatave të mbetura të rrëqebullit të Ballkanit, duke ndërtuar një bazë të fortë njohurish përmes kërkimeve natyrore dhe shkencore, si dhe aktiviteteve të monitorimit të vazhdueshëm.

Gjatë vitit 2024, u arrit një përparim i rëndësishëm. U zhvillua një studim intensiv me kamera-kurth në rajonin Polis–Guri Zi–Valamarë, në bashkëpunim me Administratën Rajonale të Zonave të Mbrojtura. Ky monitorim konfirmoi me sukses prezencën e dy individëve të llojit rrëqebull i Ballkanit në këtë zonë.



Rrëqebulli i Ballkanit (*Lynx lynx balcanicus*)

Në tetor, u organizua një sesion trajnimi mbi teknikat e monitorimit të jetës së egër për stafin e AdZM, duke ndihmuar në forcimin e kapaciteteve të tyre për përdorimin e metodave moderne, si kamera-kurth dhe metodologji gjenetike.

Përprjekjet për ndërgjegjësimin dhe komunikimin me publikun vijuan përgjatë gjithë vitit. U zhvilluan takime mujore dhe u realizuan fushata ndërgjegjësimi për të angazhuar publikun. Në shkollën Vasil Shanto në Tiranë, u pikturua një murale që promovon mbrojtjen e rrëqebullit të ballkanit, duke ndihmuar rritjen e ndërgjegjësimin për këtë lloj të gjeneratave të reja.

Gjatë vitit 2024, PPNEA pati një rol aktiv në proceset politike dhe vendimmarrëse. Organizata kontriboi me sugjerime dhe komente në Raportin e Progresit të Shqipërisë për BE-në 2024 dhe mori pjesë në rishikimin e projektligjit për gjuetinë, gjatë një mbledhjeje konsultative të organizuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit. Në muajin nëntor, PPNEA organizoi një tryezë të rrumbullakët me institucionet rajonale të veriut të Shqipërisë, ku u diskutuan sfidat që lidhen me mbrojtjen e llojeve të rrezikuara dhe nevoja për të promovuar praktika të qëndrueshme të gjuetisë.



Rrëqebulli i Ballkanit (*Lynx lynx balcanicus*)

3.2 Rezultatet dhe treguesit kryesorë 2024



MONITORIMI I LLOJEVE DHE KËRKIMI

- U vendosën **40 kamera-kurth** në 20 struktura në rajonin Polis–Valamarë (312 km²).
- U identifikuan **2 individë** të llojit **rrëqebull** i Ballkanit (30 fotografi në 4 lokacione).
- U mblodhën **14 mostra ADN/ekskrementesh** për analizë gjenetike.
- U regjistruan lloje të shumta të presë, si kaprolli, lepuiri i egër dhe dhelpra të kuqe.
- U zhvilluan **3 aktivitete monitorimi** për dhinë së egër (1 aksion ndërkuftar dhe 2 kombëtar).



NDËRTIMI I KAPACITETEVE

- 3 punonjës të PPNEA-s u trajnuan mbi vlerësimet e Listës së Kuqe dhe të Gjellbër dhe metodat e kapjes së rrëqebullit.
- U organizua 1 praktikë (Universiteti i Bielefeld-it) – 7 javë që kombinuan kërkime në terren dhe në zyrë.
- U realizua një vizitë e përbashkët në terren me MES gjatë sezonit të kapjes së rrëqebullit në Parkun Kombëtar Mavrovë.



Aksion pyllëzimi në Parkun Natyror Munellë



POLITIKA DHE ADVOKIMI

- Kontribut në Raportin e Shqipërisë për BE-në 2024.
- Ligji për Gjuetinë – rishikim, koment dhe advokim për mbrojtje më të fortë të llojeve.
- Rasti i krimeve ndaj jetës së egër – ndjekje ligjore për vrasjen e rrëqebullit në Elbasan, kundërshtim i mbylljes së çështjes.
- 37 përfaqësues institucionalë u angazhuan në tryezën rajonale të Dibrës mbi parandalimin e krimeve ndaj jetës së egër.
- Kontribut në raportin LCIE (për rreqebullin, ariun, ujkun, çakallin) dhe advokim në konferencën CMS për listimin e rreqebullit të Ballkanit.



Takim me Federatën Kombëtare të Gjuetarëve të Shqipërisë në Klos



HISTORI SUKSESI TË VËRTETUARA

- Aksion pyllëzimi me komunitetin në Munellë – mbi-jetesë e lartë e fidanëve dhe pjesëmarrje e madhe e vullnetarëve.
- Angazhimi i të rinjve përmes muralit dhe aktiviteteve shkollore.
- Fushata kundër vrasjeve të paligjshme mori mbështetje nga aktorë të ndryshëm.
- Ndikim në politikë përmes kontributit në raportin e BE-së dhe rishikimit të ligjit për gjuetinë.



Fushatë për edukimin mjedisor në 11 Qershor



Takim me Federatën Kombëtare të Gjuetarëve të Shqipërisë, Tiranë



ANGAZHIMI PUBLIK DHE NDËRGJEGJËSIMI

- U realizuan 4 fushata kryesore komunikimi (parandalimi i vrasjeve të paligjshme, restaurimi i habitatit, angazhimi i të rinjve, ri-brandimi).
- U mbollën 3,700 fidanë pishë e zezë në Munellë dhe Thirrë (shkalla e mbijetesës së fidanëve 80%, hapësira që mbulon 2 ha).
- Mbi 190 pjesëmarrës u përfshinë në aksionet e mbjelljes (banorë lokalë, institucione, vullnetarë).
- Fushata #NatureLynxUs.
- Dita Ndërkombëtare e Rrëqebullit u festua me aktivitete në 7 qytete.
- U publikua dokumentari “Ripërtëritja e Rrënjëve” në Ditën e Tokës.



Fushatë për edukimin mjedisor në 11 Qershor



Fushatë për edukimin mjedisor në 11 Qershor



OBJEKTIVAT

- Një vlerësim i lartë i mundësive dhe i rreziqeve për forcimin e popullatës së rrëqebullit ballkanik do të realizohet.
- Të gjitha grupet e interesit dhe publiku do të informohen mbi forcimin e popullatës së rrëqebullit të Ballkanit.
- Do të zhvillohet strategjia rajonale e ruajtjes për rrëqebullin e Ballkanit.
- Do të hartohen dhe miratohen planet e reja kombëtare të veprimit për rrëqebullin e Ballkanit, dhe do të nisë zbatimet e tyre.
- Statusi, shpërndarja dhe tendencat e rrëqebullit do të hulumtohen vazhdimisht.
- Vrasjet e paligjshme të rrëqebullit dhe të llojeve të presë së tij do të dokumentohen dhe raportohen në mënyrë të vazhdueshme.
- Projektet infrastrukturore do të monitorohen me kujdes dhe do të denoncohen nëse është e nevojshme.
- Zona e Mbrojtur Munellë do të mbështetet në zhvillimin dhe zbatimin e një plani menaxhimi me cilësi të lartë.
- Do të dorëzohet propozimi për bashkimin e zonave të vogla të mbrojtura në Polis-Valamarë (Shqipëri) në një të vetme.



Fushatë për edukimin mjedisor në 11 Qershor

**NATURE
LYNX
US**



RRËQEBULLI I BALLKANIT

Murali "Nature Lynx Us" në shkollën "Vasil Shanto" në Tiranë.



FUSHATË NDËRGJEGJËSIMI NË RRUGËT E TIRANËS

Që nga 27 shtatori 2024, një mural i dedikuar i rrëqebullit të Ballkanit, i rrezikuar në mënyrë kritike, është bërë pjesë e peizazhit urban të Tiranës. I pikturuar në Shkollën 9-vjeçare Vasil Shanto, në një nga kryqëzimet më të ngarkuara të kryeqytetit, murali #NatureLynxUs bashkon artin, ruajtjen e natyrës dhe angazhimin e komunitetit, për të rritur ndërgjegjësimin mbi këtë lloj kritikisht të rrezikuar.



Artisti që realizoi muralin, Franko Dine, gjatë procesit të përgatitjes



ARTI TAKON VEPRIMIN

Murali vë në pah sfidat me të cilat përballet rrëqebulli i Ballkanit dhe promovon përpjekjet për ruajtjen e tij. Duke sjellë mesazhin e mbrojtjes së natyrës në hapësirat urbane, fushata #NatureLynxUs, e udhëhequr nga PPNEA si organizatë partnere e BLRP-së, lidh ruajtjen e jetës së egër me jetën e përditshme të njerëzve.

Me zgjerimin e saj, fushata inkurajon komunitetet të angazhohen aktivisht në mbrojtjen e rrëqebullit të Ballkanit përmes artit, edukimit dhe iniciativave të ruajtjes, duke theksuar se parandalimi i zhdukjes së tij është një përgjegjësi e përbashkët.



Celebrimi i muralit me nxënësit e shkollës "Vasil Shanto"



NJË MURAL ME NJË MISION

Murali, i krijuar nga artisti Franko Dine, paraqet rrëqebullin e Ballkanit me sloganin "Nature Lynx Us". Ai thekson lidhjen midis njeriut dhe natyrës dhe nevojën për ruajtjen e mjedisit. Projekti nisi në fillim të vitit shkollor, kur nxënësit dhe stafi morën pjesë në një sesion njohës mbi Programin e Rimëkëmbjes së Rrëqebullit të Ballkanit (BLRP).

Murali është pjesë e një fushate më të gjerë ndërgjegjësimi për rrëqebullin e Ballkanit, një lloj me më pak se 50 individë të mbetur në Ballkanin jugperëndimor. Kërcënimet kryesore përfshijnë gjuetinë e paligjshme, shkatërrimin e habitatit, zhvillimet infrastrukturore dhe zjarret në pyje. Duke u frymëzuar nga rezultatet e kamerave-kurth në rajonin Polis-Valamarë, fushata planifikon të shtrihet edhe në qytete të tjera të Shqipërisë, si Elbasan, Pukë dhe Pogradec, ku gjenden gjithashtu individë të rrëqebullit.



Fushatë për edukimin mjedisor në 11 Qershor



PYJET E FUNDIT TË PARKUT NATYROR MUNELLË NË RREZIK ZHDUKJEJE

Prerja e paligjshme e drurëve në Shqipëri ka arritur nivele alarmante, veçanërisht në rajonin e Munellës. Zona të mëdha pyjore me pisha të zeza janë prerë tashmë, duke paraqitur një kërcënim serioz për mbijetesën e njërës prej habitateve më të rëndësishme natyror të vendit. Shpyllëzimi masiv, veçanërisht në pjesën jugore të Malit të Munellës, ka degraduar ekosistemin e kësaj zone, që u shpall Park Natyror në vitin 2022 dhe bën pjesë në rrjetin kombëtar të Zonave të Mbrojtura të Shqipërisë.

Edhe pse Mali i Munellës ka statusin e zonës së mbrojtur, aktivitetet e paligjshme vazhdojnë. Monitorimi i PPNEA-s gjatë vitit 2024 ka zbuluar shpyllëzim të gjerë, duke ndezur alarmin për humbjen e mundshme të kësaj pasurie natyrore të çmuar, jo vetëm për biodiversitetin, por edhe për komunitetet lokale që varen prej saj.

Mali i Munellës është strehë e rëndësishme për një gamë të gjerë të llojeve të jetës së egër, përfshirë rrëqebullin e Ballkanit, një nga gjitarët më të rrezikuar në Evropë. Shkatërrimi i habitatit të tij përmes prerjes së paligjshme të drurëve dëmton përpjekjet e vazhdueshme për restaurimin dhe ruajtjen e këtij territori.

PPNEA bën një apel urgjent ndaj autoriteteve përgjegjëse për të marrë masa të menjëhershme për të adresuar këtë situatë alarmante. Nevojitet verifikim dhe ndërhyrje urgjente për të ndaluar këtë fenomen dhe për të parandaluar aktivitete të mëtejshme të paligjshme. Nëse nuk vepron tani, pylli dikur i gjallë së shpejti do të jetë vetëm një kujtim, dhe peizazhi i Munellës rrezikon të reduktohet në një tokë të shkretë.



Praku Natyror Munellë



Takim me Federatën Kombëtare të Gjuetarëve të Shqipërisë në Klos



NJË THIRRJE E PËRBASHKËT: MBRONI RRËQEBULLIN E BALLKANIT

Humbja e habitatit, gjuetia e paligjshme dhe vrasjet e paligjshme e kanë shtyrë rrëqebullin e Ballkanit në prag të zhdukjes. Mbijetesa e tij tani varet nga veprime urgjente dhe të bashkuara.

Gjatë vitit 2024, thirrjet nga të dyja anët e kufirit, institucionet, shkollat, mediat dhe komunitetet e aktivistëve u bashkuan në një fushatë të fuqishme, duke përcjellë një mesazh të qartë:

“Mburo rrëqebullin e Ballkanit. Thua Jo Vrasjeve të Paligjshme!”

Kjo fushatë u bë më shumë se një përpjekje ndërgjegjësimi; ishte një moment i përbashkët përgjegjësie, që tregon se njerëzit kudo mund, dhe duhet, të flasin për natyrën. Por historia nuk mbaron këtu.

Ju gjithashtu jeni pjesë e kësaj lëvizjeje. Duke ndarë thirrjen, mesazhin dhe angazhimin tuaj, ju forconi zërin që kërkon mbrojtjen e rrëqebullit dhe eko-sistemeve që ai përfaqëson.

PROTECT THE BALKAN LYNX: SAY NO TO ILLEGAL


killing!

**MBRONI RRËQEBULLIN E BALLKANIT:
THUAJ JO VRASJES SË PALIGJSHME**

KAPITULLI

4

#PRESPANET



Në një pellg ujëmbledhës ndërkufitar si ai i Prespës, është e rëndësishme të ketë koordinim dhe bashkëpunim, pasi nuk do të ketë rezultate nëse vetëm njëra palë bën më shumë se tjetra, dhe nuk mbrojmë pellgun ujëmbledhës si një i tërë.

#PrespaNet është një rrjet OJQ-sh që punojnë së bashku në pellgun ujëmbledhës të Prespës. PPNEA, së bashku me Shoqatën Ekologjike të Maqedonisë (MES) nga Maqedonia e Veriut dhe Shoqata për Mbrojtjen e Prespës (SPP) nga Greqia, nënshkruan përmes një marrëveshjeje në vitin 2013 bashkëpunimin e tyre të hershëm dhe punën e tyre prej shumë vitesh në të treja anët e pellgut ujëmbledhës, duke krijuar rrjetin “PrespaNet”. Rrjeti zhvilloi një Plan Strategjik Ndërkufitar me qëllim mbrojtjen dhe ruajtjen e natyrës dhe vlerave natyrore të Prespës.

Misioni i PrespaNet është të krijojë sinergji dhe të koordinojë aktivitetet, si dhe të forcojë bashkëpunimin ndërkufitar, duke bërë përpjekje për të kapërcyer hendekun që krijohet nga mungesa e bashkëpunimit institucional. Përmes punës së përbashkët dhe pranisë lokale, rrjedha e informacionit mund të përmirësohet dhe të ndikojë në politikat mjedisore në pellgun ujëmbledhës të Prespës. E gjithë puna e ruajtjes që ndërmerr rrjeti bazohet në shkencë të mirë, përvojë në terren dhe në punën e jetesën në zonë.

4.1 “Forcimi i Ruajtjes së Mjedisit të Drejtuar nga OJQ-të në Pellgun Ujëmbledhës Ndërkufitar të Prespës”



Vendndodhja:

Parku Kombëtar i Prespës, Shqipëri



Kohëzgjatja:

2024–2027



Partnerët: PPNEA, MES, SPP, AdZM Korçë, Bashkia e Pustecit, Universiteti i Korçës

Projekti i Prespës forcon mbrojtjen e biodiversitetit në eko-rajonin Prespë–Ohër–Shebenik, një nga peizazhet më unike ndërkufitare të Europës. Misioni i tij kryesor është të mbrojë llojet e rrezikuara, të restaurojë habitatet dhe të sigurojë menaxhim të qëndrueshëm të ujit dhe ligatinave përmes shkencës, edukimit dhe angazhimit të komunitetit.

Gjatë vitit 2024, përpjekjet u përqendruan në:

- Zgjerimin e monitorimit të ujit, ligatinave dhe llojeve kyçe.
- Angazhimin e shkollave, studentëve dhe komuniteteve në ruajtjen e natyrës.
- Forcimin e PrespaNet si një platformë ndërkufitare për bashkëpunim rajonal.

Objektivat:

Objektivi 1: Përmirësimi i njohurive dhe hulumtimeve mbi gjendjen e ujit të Liqenit të Prespës dhe krijimi i një kuptimi të përbashkët në nivel ndërkufitar.

Objektivi 2: Monitorimi i ligatinave, promovimi i qëndrueshmërisë së ujit dhe ruajtja e biodiversitetit lokal.

Objektivi 3: Organizimi i rregullt i hulumtimit dhe monitorimit ndërkufitar të shpendëve të ujit nga partnerët e PrespaNet me përfshirjen e Zonave të Mbrojtura.

Objektivi 4: Ndërtimi i kapaciteteve dhe rritja e ndërgjegjësimit të mbrojtësve të rinj në Shqipëri dhe në Eko-rajonin Prespë–Ohër–Shebenik përmes monitorimit të jetës së egër.


Objektivi 5: Kryerja e monitorimit dhe hulumtimit mbi llojet kyçe të gjitarëve të rrezikuar në Parkun Kombëtar të Prespës dhe Parkun Kombëtar të Shebenikut.

Objektivi 6: Kryerja e një studimi të fokusuar për vlerësimin e konflikteve njeri-jetë e egër në Parkun Kombëtar të Shebenikut dhe implementimi i masave përkatëse.

Objektivi 7: Identifikimi i krimeve ndaj jetës së egër duke përfshirë aktorët dhe institucionet kyçe nga pellgu ujëmbledhës ndërkufitar i Prespës.

Objektivi 8: Vlerësimi i perceptimeve, karakteristikave dhe funksionalitetit të peizazhit në pellgun ujëmbledhës ndërkufitar të Prespës.

Objektivi 9: Bashkëpunimi ndërkufitar forcon partneritetin e rrjetit dhe rrit kapacitetin e sektorit të OJQ-ve në Prespë.



Myotis myotis



4.2 Evente dhe tregues kryesorë në vitin 2024

Hulumtim dhe Monitorim

- **Monitorimi i cilësisë së ujit:** Nisi programi i parë i plotë hidrologjik (u instaluan pizometra, parametrat u analizuan).
- **Monitorimi i biodiversitetit:**
 - 4 monitorime të shpendëve të ujit , përfshirë Censusin Ndërkombëtar të Shpendëve të Ujit dhe Censusin e Pelikanit të Europës Juglindore.
 - 10 familje me 24 të vegjël të llojit Zhytësi i mesëm (*Mergus merganser*) u regjistruan.
 - Kamerat-kurth konfirmuan praninë e kaprollit, ariut të murrmë, derrit të egër, maces së egër dhe ujkut.
 - Dhia e egër u vëzhgua në Parkun Kombëtar të Shebenikut (2 individë).
 - 70 individë të gjarprit të vogët të shiut (*Natrix tessellata*) në ishujt Maligrad dhe Golem Grad.
 - Habitatet: u ruajtën vendet e restaurimit të vërritit të zi; u përfundua hartëzimi ortofotografik i habitatit buzë-liqenit.
 - U regjistruan 2500 lloje lakuriq nate dhe dhjetëra shpella u vizituan për numërimin gjatë dimrit.

Edukimi dhe ndërtimi i kapaciteteve

- Mbi 500 nxënës nga 10 shkolla u përfshinë në edukim mjedisor.
- 18 studentë dhe 2 praktikantë morën pjesë në shkollën verore ndërkufitare.
- 3 punime diplome u mbështetën në bashkëpunim me Universitetin e Korçës.
- 2 evente të mëdha për të rinjtë: kampet unazore të shpendëve dhe “Nata Ndërkombëtare e Lakuriqëve të Natës”.

Angazhimi i komunitetit dhe politikat

- U nënshkrua memorandum mirëkuptimi me organizatat e menaxhimit të peshkimit – Prespa.
- Bujq, barinj, grupet e grave dhe peshkatarët lokalë



Censusi i shpendëve në Parkun Kombëtar të Prespës



Aksion pyllëzimi në Prespën e Vogël

u angazhuan për mbrojtjen e biodiversitetit dhe menaxhimin e ujit.

- U instaluan 6 tabela rrugore për kalimin e jetës së egër.

Bashkëpunimi ndërkufitar

- Mbledhje koordinimi trilaterale për shpendët e ujit (Prill 2024).
- Pjesëmarrje në punëtorinë për Menaxhimin e Ligatave Ndërkufitare (Greqi).
- Shkolla verore, kampet unazore të shpendëve dhe misionet e përbashkëta të monitorimit forcan besimin ndërkufitar dhe shkëmbimin e njohurive.

Ndikimet kryesore 2024

- Ruajtje e bazuar në shkencë: Programi i parë i monitorimit të ujit në Prespë; të dhëna më të mira për llojet për menaxhim të informuar.
- Angazhimi i të rinjve: Mbi 500 nxënës, me shumë se 20 studiues të rinj dhe disa punime diplome të lidhura me ruajtjen praktike.
- Fuqizimi i komunitetit: Memorandum mirëkuptimi me peshkatarët që formalizoi bashkëpunimin; bujq



Censusi i shpendëve të ujit në Parkun Kombëtar të Prespës



Aksion pyllëzimi në Prespën e Vogël

- dhe gra u përfshinë në menaxhimin e ekosistemit.
- Forca rajonale: PrespaNet u konsolidua si një platformë ndërkufitare për advokim, monitorim dhe veprime për ruajtjen e natyrës.
 - Rëndësia ndërkombëtare: Aktivitetet u përputhën me strategjinë e Bashkimit Evropian për biodiversitetin, Marrëveshjen e Gjellbër, CBD, AEWA dhe nismën Balkan Green Belt.

CBD, AEWA dhe nismën Balkan Green Belt. Perspektivat e Ardhshme (2025–2026)

- Vazhdimi i monitorimit të biodiversitetit (gjitarët, shpendët e ujit, hidrologji).
- Zgjerimi i programeve ndërkufitare për edukimin dhe të rinjtë.
- Forcimi i advokimit kundër gjuetisë dhe peshkimit të paligjshëm, si dhe për energji të rinovueshme.
- Përmirësimi i ekoturizmit dhe ndërgjegjësimit (Festivali i Prespës, materiale komunikimi, Platforma Prespa).
- Ndërtimi i kapaciteteve organizative për ofrimin e ruajtjes së natyrës në afat të gjatë.



Edukim mjedisor



Aksion pyllëzimi në Prespën e Vogël

Porteti i shkollës verore ndërkufitare të Prespës

Gjatë vitit 2024, 21 studentë nga Shqipëria, Maqedonia e Veriut dhe Greqia u mbledhën për shkollën verore ndërkufitare të Prespës. Ky program njëjavor kombinoi mësimin praktik, hulumtimin në terren dhe bashkëpunimin ndërkufitar, duke u ofruar pjesëmarrësve njohuri të veçanta mbi shkencën e ruajtjes së natyrës dhe menaxhimin mjedisor.

Eksplorimi i ujit, shpendëve dhe gjitarëve.

Që nga dita e parë, studentët u angazhuan në aktivitete praktike si studime të shpendëve të ujit, teknika të censusit, identifikimi i shpendëve dhe sesione të unazimit të tyre në Zaroshkë. Ata mësuan rëndësinë e monitorimit të cilësisë së ujit dhe eksploruan habitatet prioritare, përfshirë pyjet e vëriut të zi, duke fituar përvojë direkte mbi rolin që këto ekosisteme luajnë në ruajtjen e ekuilibrit ekologjik.



Shkolla Verore e Prespës 2024



Liqeni i Prespës

Zbulimi i reptilëve dhe jetës ujore

Gjatë javës, studentët eksploruan Ishullin Maligrad dhe Prespën e Vogël, duke studiuar reptilë si gjarpërinjtë e ujit (*Natrix tessellata*) dhe gjitarë gjysmë-ujorë si lundërza. Ata ndihmuan ekspertët në inspektimin e rrjetave të peshkimit, monitorimin e popullatës së peshqve dhe kuptuan më shumë mbi dinamikën e ekosistemeve ujore.

Mësimi përmes teknologjisë dhe punës në terren

Pjesëmarrësit praktikuan vendosjen e kamerave-kurth për monitorimin e gjitarëve të mëdhenj, duke përfshirë rrëqebullin e Ballkanit, dhinë e egër, ariun e murrmë, derrin e egër dhe kaprollin. Kjo qasje praktike i mundësoi studentëve të kuptonin sjelljen e llojeve të jetës së egër, sfidat në ruajtjen e natyrës dhe rëndësinë e teknikave të monitorimit jo-invaziv.

Ndërlidhja kulturore dhe bashkëpunimi

Përtej punës në terren, programi nxiti lidhjet ndërkufitare, angazhimin me komunitetet lokale dhe aktorët kyç. Vizitat në zyrën e Parkut Kombëtar të Prespës, Bashkinë e Pustecit, si dhe bashkëpunimet me AdZM Korçë dhe organizatat partnere, theksuan përpjekjet e vazhdueshme për ruajtjen e natyrës dhe rëndësinë e aksioneve të përbashkëta.

Një përfundim i paharrueshëm

Shkolla verore përfundoi me reflektime, ndarjen e certifikatave dhe kremtimet për arritjet. Studentët u larguan jo vetëm me njohuri shkencore, por edhe me lidhje të forcuara që kapërcejne kufijte, duke përfaqësuar vizionin e PrespaNet për ruajtjen e trashëgimisë natyrore dhe kulturore për brezat e sotshëm dhe ata që do të vijnë.



Kryekuqja e mjeme (*Aythya ferina*)



Crocus sp.

KAPITULLI

5

NË NATYRËN E EGËR


5.1

Përmbyllja e një viti emocionues falë monitorimit me kamera-kurth

Kamerat kurth kanë ofruar një pasqyrë të rrallë të jetës së fshehur të gjitarëve të mëdhenj dhe të mesëm. Këta vëzhgues të heshtur kanë regjistruar lëvizjet e imta të jetës së egër ndërsa ata lëvizin në peizazhe të ashpra, duke zbuluar momente që përndryshe do të mbeteshin të padukshme.



Macja e egër, Wild cat (*Felis silvestris*)




Baldosa, Badger (*Meles meles*)



Çakalli, Golden jackal (*Canis aureus*)



Lepuri i egër, Brown hare (*Lepus europaeus*)



Ariu i murrmë, Brown bear (*Ursus arctos*)




Derri i egër, Wild boar (*Sus scrofa*)

NË NATYRËN E EGËR



Dhelpra, Red fox (*Vulpes vulpes*)



Kunadhja, Beech marten (*Martes foina*)



Rrëqebulli i ballkanit, Balkan lynx (*Lynx lynx balcanicus*)



Ujku, Grey wolf (*Canis lupus*)



Rrëqebulli i ballkanit, Balkan lynx (*Lynx lynx balcanicus*)



Kaprolli, Roe deer (*Capreolus capreolus*)

KAPITULLI

6

NDËRLIDHJA E PEIZAZHEVE

Drejt Ndërlidhjes së Zonave të
Ruajtjes Në Shqipëri

"Lumi i Gashit", Parku Kombëtar i Alpeve të Shqipërisë

6.1 Rugëtimi drejt Ruajtjes së Korridoreve Ekologjike në Shqipëri nëpërmjet Qeverisjes dhe Menaxhimit të Zonave të Mbrojtura



Vendndodhja: Korridori ekologjik Cukal–Munellë–Balgaj–Martanesh



Kohëzgjatja:
2024–2026



Partnerët:
SHERM, ICLA INLSH, Ekologët për Rajonin



Donatori:
PONT (Prespa Ohrid Nature Trust)

Ky projekt synon të krijojë kushtet për zbatimin e Zonave të Ruajtjes së Lidhshmërisë (CCAs) në Shqipëri, duke përfshirë konceptin në korridorin ekologjik Cukal–Munellë–Balgaj–Martanesh. Përpjekjet përqendrohen në ndërtimin e kapacitetit institucional, zhvillimin e modeleve të qeverisjes, forcimin e angazhimit të komunitetit, si dhe në avancimin e hulumtimeve, monitorimit dhe restaurimit të habitatit.

Objektivat

- Të ndërtohet një kuptim i përbashkët i konceptit të korridoreve ekologjike duke u fokusuar në një zonë pilote.
- Të forcohet kapaciteti dhe ndërgjegjësimi i administratave dhe institucioneve të zonave të mbrojtura.
- Të zhvillohet një model pilot qeverisjeje për korridoret ekologjike.
- Të zbatohet hulumtim, monitorim dhe restaurim për llojet kyçe në AANP dhe KKNP.

Aktivitetet Kryesore (2024)

Planifikimi pjesëmarrës dhe dimensionimi njerëzor

- U organizuan ecje transekti në Skavicë, Bulqizë dhe Radomirë për të informuar qeverisjen dhe planifikimin e veprimeve.
- Katër “mini-korridore ekologjike” u identifikuan si vende udhërrëfyese për aktivitetet.
- Studimi i Dimensionit Njerëzor u përfundua në fillim të 2024; rezultatet mbi habitatet, kërcënimet dhe jetesën do të publikohen në pranverë 2025.

Angazhimi i komunitetit dhe tryezat e rrumbullakta

- Bashkia Librazhd: prezantoi nismën e korridoreve ekologjike dhe bashkëpunoi për “Festivalin e Yjeve” (Gusht 2024).
- Bashkia Klos: tryezë e rrumbullakët mbi llojet e rrekuara dhe gjuetinë e qëndrueshme me pjesëmarrjen e policisë, gjuetarëve, organizatave lokale dhe Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit (Nëntor 2024).

Punë ligjore dhe politike

- U krye një analizë ligjore e legjislacionit pyjor të Shqipërisë me mbështetjen e IUCN, duke identifi-



Fidanishtja Trees for Lura

kuar boshllëqet dhe duke ofruar rekomandime të përputhura me BE-në për qeverisjen e pyjeve dhe korridoret ekologjike.

Edukimi dhe ndërgjegjësimi

- Shfaqje e dokumentarit “Ripërtëritja e Rrënjëve” me nxënës të shkollave të mesme në Bulqizë.
- Angazhimi i studentëve gjatë pjesëmarrjes në panairë dhe takime universitetet, duke ndërtuar lidhje të forta me profilin akademik dhe duke krijuar perspektiva të mira për përfshirjen e studentëve në hulumtimet e korridoreve ekologjike.

Ndërtimi i kapaciteteve dhe ndarje përvojash

- Workshop (Tetor 2024, Ulëz PN): trajnim i stafit të AdZM-ve nga 7 rajone mbi monitorimin e llojeve në korridoret ekologjike, duke përdorur telemetri, metodologji gjenetike dhe e-ADN.
- Ndarje përvojash (Nëntor 2024, Peshkopi): PPNEA dhe SHERM pritën Grupet Lokale të Veprimit nga Vjosa dhe Korab–Koritniku, duke u fokusuar në ekoturizëm e sigurimi i jetesës, duke sjellë dhe rolin e korridoreve ekologjike.

Hulumtim dhe monitorim

- Kamera-kurth (Qershor 2024): 8 kamera të vendosura në Parkun Kombëtar Lurë–Dejë regjistruan ariun e murrme, kaprollin, macen e egër dhe ujkun. Deri tani nuk është vëzhguar rrëqebulli i Ballkanit.
- Monitorimi i dhisë së egër (Nëntor 2024): Edhe pse nuk u vëzhgua drejtpërdrejt në Parkun Natyror të Munellës, banorët dokumentuan një grup që kalonte lumin Fan, duke konfirmuar praninë në këtë korridor prioritar për rrëqebullin.







Liqeni i Zi, Radomirë

Mbështetje e Zonave të Mbrojtura

- Parku Natyror Korab–Koritnik: CCA u integrua në diskutimet e menaxhimit; pjesëmarrje në analizën METT (Tetor 2024).
- Parku Kombëtar i Alpeve të Shqipërisë: lobimi u përfshi në projektin e ri të biodiversitetit GEF7 (Dhjetor 2024).

Rrjetëzim rajonal dhe ndërkombëtar

- Forumi Rajonal i IUCN (Tetor–Nëntor 2024, Bruges).
- Samiti i Ballkanit Perëndimor (Tetor 2024, Berlin).
- Takimi BioNET (Nëntor 2024, Shkodër).

Partneritete

- Bashkëpunim i fuqizuar me Trees for Lurë, AgroEkoD-ibra, Grupin Lokal të Veprimit Sharr–Korab–Koritnik.
- Kontribut në studimin e fizibilitetit për korridorin ekologjik “Tomorr–Vjosa”.

Rezultatet dhe treguesit

- Përfshirja e komunitetit:
 - 5 udhëheqës të komunitetit të angazhuar.
 - Është zhvilluar 1 plan ruajtjeje për llojet/habitatet.
 - 4 praktika të qëndrueshme mbështeten përmes granteve të OJQ-ve lokale.
- “Festivali I Yjeve”, Shebenik



“Festivali i Yjeve”, Shebenik

Shkëmbimi i njohurive:

- 10 anëtarë të qeverisjes të zonave të mbrojtura të trajnuar.
- 3 punëtori të përbashkëta me universitete dhe përfaqësues të zonave të mbrojtura.
- 75 pjesëmarrës.
- 2 grante kërkimore për studentë.

Sfidat dhe mësimet e nxjerra

- Nuk pati pengesa të mëdha, por prezantimi i korridoreve ekologjike është një proces mësimi që kërkon kohë dhe përshtatje.
- Fokusimi te aksionet afatgjata nxit bashkëpunim më të thellë dhe rezultate më të forta.



Drini i Zi

Hapat e ardhshëm (2025–2026)

- Nisja e skemës së mini-granteve në Parkun Kombëtar Shebenik.
- Organizimi i një kampi veror transkufitar mbi agro-biodiversitetin (Korab–Koritnik).
- Zhvillimi i një modeli qeverisjeje për korridoret ekologjike.
- Zgjerimi i monitorimit të jetës së egër me kamera-kurth dhe me kuti-kurth.
- Mbështetje e pyllëzimit me Ekologët për Rajonin Kukës.
- Simpozium Kombëtar mbi ndërlidhjen e habitateve.

Ndikimi politik dhe advokimi


Pjesëmarrja aktive në forumet rajonale dhe ndërkombëtare (IUCN, Samiti i Berlinit, BioNET) siguroi që nisma e korridoreve ekologjike në Shqipëri të fitonte dukshmëri dhe kontribuoi në dialogun europian mbi ruajtjen e ndërlidhjes.

Qëndrueshmëria dhe ndikimi afatgjatë

Projekti krijon themele për integrimin e korridoreve ekologjike në qeverisjen dhe legjislacionin e zonave të mbrojtura në Shqipëri, me angazhimin e fortë të komunitetit, partneritete dhe mbështetje institucionale, duke siguruar vazhdimësi përtej afatit të projektit.

Rezultatet e pritshme:

Rezultatet	Indikatorët
1. Komunitetet lokale në korridorin e zgjedhur janë aktivisht të angazhuara në menaxhimin e korridoreve ekologjike	1. 5 udhëheqës komuniteti të identifikuar dhe të angazhuar vullnetarisht. 1 plan komunitar për ruajtjen e një lloji/ habitatit të caktuar.
2. Praktikrat e qëndrueshme të menaxhimit të burimeve natyrore të komunitetit janë identifikuar dhe mbështetur me një skemë sub-grantesh	2. Të paktën 4 praktika të qëndrueshme të mbështetura përmes granteve të OJQ-ve lokale.
3. Njohuritë dhe përvojat shkëmbehen midis institucioneve përkatëse, dhe bashkëpunimi forcohet për zbatimin e projektit të korridoreve ekologjike	3. 10 anëtarë të organeve të qeverisjes të zonave të mbrojtura pjesëmarrës në dy punëtori trajnimi. 3 punëtori të përbashkëta me përfaqësues të zonave të mbrojtura dhe universitetet. 75 pjesëmarrës në total. 2 grante kërkimore për studentë.



KAPITULLI

7

NATYRA KA NEVOJË PËR ZË

Nisma kyçe të ruajtjes
së natyrës

Mali I Pashtrikut

7.1 Ruajtja Ndërkufitare e Ariut të murrmë – TBBC



Vendndodhja:
Shqipëria Juglindore



Kohëzgjatja:
Korrik 2024 – Korrik 2026 (2 vite)



Partnerët:
EuroNatur (Gjermani), PPNEA (Shqipëri), Calisto (Greqi), Eko-svest (Maqedonia e Veriut), MES (Maqedonia e Veriut)

Projekti TBBC synon të promovojë **ruajtjen e qëndrueshme ndërkufitare të ariut të murrmë** në Shqipëri, në Greqi dhe në Maqedoninë e Veriut. Duke u mbështetur në bashkëpunimet e mëparshme, projekti fokusohet në monitorim të sinkronizuar, zbutjen e konflikteve, rritjen e kapaciteteve dhe ndërgjegjësimin publik, duke adresuar njëkohësisht fragmentimin e habitateve dhe të popullatave përgjatë peizazhit Prespë–Munellë.

Objektivat

- Të promovohet bashkëpunimi për ruajtjen e qëndrueshme ndërkufitare të ariut të murrmë.
- Të zhvillohen programe të përbashkëta për monitorimin e ariut.
- Të zbuten konfliktet njeri–ari përmes krijimit dhe funksionimit të ekipit të ndërhyrjes për ariun (BIT).
- Të forcohen kapacitetet institucionale në luftën kundër krimit ndaj jetës së egër.
- Të rritet ndërgjegjësimi dhe përfshirja e aktorëve lokalë e rajonalë.

Rezultatet e pritshme

- Kapacitete institucionale më të forta dhe kuadër afatgjatë për ruajtjen e ariut të murrmë.
- Zbatim i masave praktike për reduktimin e fragmentimit të habitateve dhe popullatave, të integruara në planifikimin e infrastrukturës.
- Monitorim i sinkronizuar i ariut dhe shkëmbim i të dhënave ndërmjet vendeve pjesëmarrëse.
- Hartimi i një **plani veprimi rajonal trilateral për ariun**, i bazuar në shkencë dhe në kontributin e aktorëve përkatës.
- Përmirësimi i bashkëjetesës njeri–ari përmes mekanizmave të reagimit emergjent dhe masave të zbutjes së konflikteve.



Ariu "Maja"

- Reduktim i praktikave të paligjshme përmes ndërhyrjeve ligjore dhe forcimit të kapaciteteve.
- Komunitete, shkolla dhe operatorë turistikë më të informuar dhe të angazhuar në praktika të qëndrueshme.

Aktivitetet kryesore dhe arritjet (Korrik–Dhjetor 2024)

Nisja dhe koordinimi i projektit

- **Takimi i parë në Berat (tetor 2024):** 11 anëtarë nga të gjitha organizatat partnere u mbledhën për të rishikuar rezultatet e projektit të mëparshëm Tripoint Brown Bear Project dhe për të planifikuar aktivitetet për dy vitet në vijim. Ky ishte takimi i parë fizik i projektit TBBC, i cili forcoi ndjeshëm bashkëpunimin dhe motivimin e ekipit.
- U identifikuan dhe u përfshinë **aktorët kryesorë** në grupin e punës, me fokus në rishikimin e planit të vepërimit për ariun në pellgun ujëmbledhës të Prespës.

Kërkimi dhe monitorimi – Historia e Majës

- U zhvilluan **tre ekspedita** të përbashkëta nga PPNEA dhe Calisto për heqjen e sigurt të transmetuesit satelitor me radio të Majës, një arushë e shpëtuar nga një kurth i paligjshëm në dhjetor 2023.
- Studimi me telemetri që zgjati 10 muaj ofroi **për herë të parë në Shqipëri të dhëna shkencore mbi lëvizjet dhe përdorimin e habitatit nga një lloj gjatari**, duke shënuar një arritje të rëndësishme kërkimore.
- Një ekspeditë e mëvonshme në dhjetor 2024 u përpoq të lokalizonte vendstrehimin dimëror të Majës; megjithëse nuk u gjet, u vendos **një kamera kurth në një shteg pranë zonës për të mbledhur të dhëna shtesë dhe materiale ndërgjegjësuëse.**
- Ky bashkëpunim theksoi rëndësinë e **koordinimit ndërkufitar dhe ndërinstitucional**, duke përfshirë autoritetet shqiptare të rendit, dhe vendosi një precedent pozitiv për ndërhyrjet e ardhshme në mbrojtjen e jetës së egër.



Në gjurmët e Majës nëpërmjet metodës me telemetri

Ndërgjegjësimi dhe Komunikimi

- Rasti i Majës ka gjeneruar një ndikim të gjerë në rritjen e ndërgjegjësimin publik dhe ka forcuar komunikimin mbi ruajtjen e ariut në Shqipëri dhe rajon.
- Projekti është angazhuar që të bëjë të aksesueshme për publikun të dhënat e mbledhura nga studimi me telemetri, me qëllim rritjen e mbështetjes për mbrojtjen e mishngrënësve të mëdhenj dhe promovimin e një bashkëjetese më të qëndrueshme midis njerëzve dhe jetës së egër.

Hapat e ardhshëm (2025–2026)

- Hartimi i një plani për zbutjen e fragmentimit të habitateve dhe finalizimi i planit të veprimit për ariun e murrmë në pellgun ujëmbledhës të Prespës.
- Identifikimi dhe zbutja e zonave kritike të fragmentimit të habitatit përmes masave të restaurimit dhe rritjes së ndërlidhjes ekologjike.
- Advokim në nivele politike dhe ligjore për të reduktuar kërcënimet nga infrastruktura gri dhe për të forcuar rrjetet e zonave të mbrojtura.
- Kryerja e monitorimit të përbashkët të arinjve në nivel ndërkufitar për përmirësimin e të dhënave, aftësive dhe identifikimin e korridoreve ekologjike.
- Promovimi i **ekipit të ndërhyrjes për arinjtë (BIT)**, duke siguruar institucionalizimin dhe aftësinë e tij për t'iu përgjigjur konflikteve njeri-ari.
- Parandalimi i vrasjeve të paligjshme përmes ndërhyrjeve të synuara, forcimit të kapaciteteve dhe bashkëpunimit me organet e rendit.
- Zbatimi i **fushatave të ndërgjegjësimin publik** dhe instalimi i tabelave rrugore në pikat kryesore të kalimit të ariut.

Ndikimi dhe trashëgimia

Projekti TBBC ndërton themelet për një ruajtjeje afatgjatë, të bazuar në shkencë dhe me qasje ndërkufitare për ariun e murrmë. Ai jo vetëm që forcon kapacitetet institucionale dhe komunitare, por gjithashtu shërben si shembull i suksesshëm bashkëpunimi ndërmjet vendeve, siç tregohet në rastin e Majës, një rast historik dhe pikë kthese për ruajtjen e natyrës në Shqipëri.

Një histori e trishtë me fund të lumtur: Ariu Maja, nga shpëtimi te hulumtimi

Në dhjetor 2023, Maya, një arushë i murrmë nga lartësitë e Mokrës, u gjet e kapur në një kurth pranë fshatit Çezma. Falë ndërhyrjes së shpejtë të PPNEA, Callisto, ekipit shqiptar të shpëtimit të jetës së egër, RAPA Korçë dhe policisë së shtetit, ajo u shpëtua në mënyrë të sigurt dhe u bë ariu i parë në Shqipëri i pajisur me një transmetues satelitor GPS.

Gjatë 10 muajve pasues, pajisja ofroi të dhëna të vlera mbi lëvizjet dhe vendbanimin e saj, duke pasuruar ndjeshëm njohuritë shkencore mbi ekologjinë e arinjve dhe nevojat për ruajtjen e tyre në Shqipëri. Së fundmi, ekipi për arinjtë të PPNEA-s e hoqën me sukses pajisjen, duke mbyllur një kapitull të rëndësishëm të udhëtimit të Majës.

Rasti i Majës tregon shpresë dhe alarm njëkohësisht: shpëtimi i saj tregon se çfarë mund të arrihet përmes bashkëpunimit midis organizatave, ekspertëve dhe institucioneve, por gjithashtu nënvizon kërcënimin e vazhdueshëm nga kurthet e jashtëligjshme, një praktikë e përhapur dhe e rrezikshme që kërcënon jo vetëm arinjtë (me një popullatë të vlerësuar nën 200 individë në Shqipëri), por edhe shumë lloje të tjera.

Historia e Majës shërben si paralajmërim dhe frymëzim, një kujtesë se veprimi i përbashkët është thelbësor për të mbrojtur llojet e rrezikuara dhe për të siguruar një botë natyrore më të shëndetshme për brezat që do të vijin.



Gjurmë ariu

7.2 Pyjet Përtej Kufijve



Vendndodhja: Shqipëri, Maqedoni e Veriut dhe Ballkani Perëndimor




Kohëzgjatja:
Qershor 2022 – Dhjetor 2024



Partnerët: Qendra për Mjedisin, BIOM, Centar za zaštitu i proučavanje ptica Crne Gore, Društvo za zaštitu i proučavanje ptica Srbije, Macedonian Ecological Society, Bionet, PPNEA, Space for Good



Donatori:
EuroNatur



Pyje të vjetër

Pyjet ndërkufitare të Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut përbëjnë habitatet kyçe për mishngrënësit e mëdhenj, përfshirë rrëqebullin e Ballkanit dhe ariun e murrmë. Këto peizazhe të pasura me biodiversitet përballen me presione nga menaxhimi i paqëndrueshëm, qeverisja e dobët dhe mungesa e mbrojtjes të harmonizuar ndërmjet vendeve. Projekti “Pyjet përtej Kufijve” synon të forcojë ruajtjen rajonale të pyjeve përmes shkencës, reformave ligjore dhe bashkëpunimit ndërkufitar.

Objektivat

- Vlerësimi i gjendjes aktuale të pyjeve primare dhe të vjetër (PF/OGF) në Ballkanin Perëndimor.
- Zhvillimi i një metode dhe mjeti të harmonizuar për identifikimin dhe kartografin e PF/OGF-ve.
- Krijimi i një harte rajonale të PF/OGF-ve për të udhëhequr planifikimin e ruajtjes.
- Analizimi dhe përmirësimi i kuadrit ligjor që rregullon PF/OGF-të në Shqipëri dhe rajon.
- Mbështetja e masave për të forcuar mbrojtjen dhe për t'i përputhur me legjislacionin e BE-së.

Aktivitetet kryesore (2022–2024)


- Zhvillimi i një metodologjie të harmonizuar për identifikimin e pyjeve primare dhe të vjetër (PF/OGF) në të gjithë Ballkanin Perëndimor.
- Krijimi i një harte rajonale gjithëpërfshirëse të PF/OGF-ve duke përdorur metodologjinë e dakordësuar.
- Publikimi i një dokumenti, analize ligjore, mbi qeverisjen e pyjeve në Shqipëri, duke vlerësuar legjislacionin kombëtar, përputhshmërinë me BE-në dhe boshllëkun në zbatim.
- Konsultime me palët e interesuara dhe advokim për të promovuar politika më të forta mbrojtjeje të pyjeve.

Rezultatet

- Hartë rajonale e PF/OGF-ve e prodhuar, duke ofruar një pasqyrë të unifikuar për shpërndarjen e pyjeve të vjetër në Ballkanin Perëndimor për herë të parë.
- Analizë ligjore e publikuar për Shqipërinë, duke identifikuar dobësitë në qeverisjen aktuale dhe duke ofruar rekomandime konkrete për përmirësimin e mbrojtjes ligjore.
- Rritja e kapaciteteve të palëve të interesuara për të përdorur të dhëna shkencore dhe njohuri ligjore në mbrojtjen e pyjeve.

Ndikimi

Ky projekt ka krijuar një bazë shkencore dhe ligjore për mbrojtjen e pyjeve në Shqipëri dhe rajon. Duke harmonizuar metodat e hartëzimit dhe duke prodhuar një pasqyrë rajonale, ai mundëson veprim të koordinuar për ruajtjen ndërkufitare, duke mbështetur mbijetesën e llojeve kyçe si rrëqebulli i Ballkanit.



7.3 Nisma e Pyjeve Veriore – Restaurimi i pyjeve në Maqedoninë e Veriut dhe në Shqipëri



Vendndodhja: Zona e Bukovikj (Maqedonia e Veriut) dhe zona Pashtrik–Morina (Shqipëri). Këto ndodhen në kryqëzimin e disa zonave të mbrojtura në të dy vendet, përfshirë Parkun Kombëtar Malësia e Sharrit, Rezervatin Natyror Jasen, Parkun Kombëtar Mavrovo, Parkun Natyror Korab–Koritnik, Parkun Natyror Munellë dhe Parkun Kombëtar Alpet e Shqipërisë.




Kohëzgjatja:
2022 – 2025



Partnerët:
IUCN, PPNEA, MES



Donatori:
Swedish Postcode Lottery Foundation



Mali i Pashtrikut

Nisma e Pyjeve Veriore mbështet restaurimin e pyjeve dhe menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve në Shqipëri dhe Maqedoninë e Veriut. Këto peizazhe pyjore janë ekologjikisht të rëndësishme, duke ofruar strehë për mishngrënësit e mëdhenj dhe lloje të tjera, ndërsa gjithashtu mbështesin jetesën e komuniteteve lokale. Megjithatë, ata përballen me degradim për shkak të përdorimit jo të qëndrueshëm dhe qeverisjes së dobët.

Objektivat

- Zhvillimi i zgjidhjeve për restaurimin e peizazheve pyjore (FLR) në vendet pilote në të dy vendet.
- Përmirësimi i njohurive dhe kapaciteteve të institucioneve, komunave dhe komuniteteve për restaurimin e pyjeve.
- Forcimi i angazhimit për menaxhim të qëndrueshëm dhe bashkëpunim ndërkufitar.

Aktivitetet kryesore (2022–2024)

- Ndërtimi i kapaciteteve:
 - 1 trajnim mbi qeverisjen e pyjeve për 15 zyrtarë komunalë.
 - 2 punëtori me ruajtësit komunitar mbi praktikatat e monitorimit dhe restaurimit.

Hulumtim dhe monitorim:

- Vlerësimi i kushteve të pyjeve në Bukovikj dhe Pashtrik–Morina.
- Hartimi i planeve të përshtatura të restaurimit.

Dialog politik:

- Angazhimi me autoritetet lokale dhe Administratat e Zonave të Mbrojtura.
- Shkëmbim njohurish mes Shqipërisë, Maqedonisë së Veriut dhe partnerëve ndërkombëtarë.

Rezultatet

- Forcimi i bazës së njohurive mbi gjendjen e pyjeve dhe nevojat për restaurim në vendet pilote.
- Rritja e kapacitetit të komunitetit për të integruar restaurimin dhe qeverisjen në menaxhimin e pyjeve.
- Krijimi i një dialogu rajonal, duke lidhur aktorët lokalë me iniciativat ndërkombëtare të restaurimit.

Ndikimi

Projekti ka vendosur bazat për rikuperimin e pyjeve në zonat kritike ndërkufitare. Duke kombinuar punën teknike të restaurimit me përmirësimet në qeverisje, forcon si ekosistemet ashtu edhe komunitetet që varen prej tyre.



Trajnim për Menaxhimin e Qëndrueshëm të Pyjeve në Tiranë



WE GO COOP

Interreg
Euro-MED



Co-funded by
the European Union



Seminar për rritjen e kapaciteteve dhe shkëmbimin e përvojave mbi Kontratat e Ligatinave dhe aktivitetet informuese në rajonin Euro-Mesdhetar



Seminar për rritjen e kapaciteteve dhe shkëmbimin e përvojave mbi Kontratat e Ligatinave dhe aktivitetet informuese në rajonin Euro-Mesdhetar

7.4 WeGOCOOP – Përmirësimi i qeverisjes së ligatinave përmes një komuniteti praktik



Vendndodhja: Peizazhi i Mbrojtur Vjosë–Nartë (Shqipëri) në kuadër të bashkëpunimit në nivel Mesdhetar



Kohëzgjatja:
2 vjet



Partnerët: ANATOLIKI, UNIROMA3, MedWet, NPVL, FAMP, RCDI, PPNEA

Donatori:

Programi Interreg Euro-MED
(financuar nga BE)

Ligatinat janë ndër ekosistemet më të kërcënuara në Mesdhe, duke përballur presione nga zhvillimi i infrastrukturës, ndotja dhe menaxhimi i dobët. Projekti WeGOCOOP synon të adresojë këto sfida duke promovuar kontratat e ligatinave, një mjet pjesëmarrës i qeverisjes që forcon bashkëpunimin midis autoriteteve, palëve të interesuara dhe komuniteteve për ruajtjen e lagunave.

Objektivat

1. Të krijohet një komunitet praktikash (CoP) për kontratat e ligatinave në nivel Mesdhetar.
2. Të ndahen përvojat, metodologjitë dhe zgjidhjet midis rajoneve të ndryshme.
3. Të transferohet metoda e kontratës së ligatinave në kontekste të reja, përfshirë Shqipërinë, Kroacinë dhe Portugalin.
4. Të nxisë bashkëpunimin ndërkombëtar dhe zhvillimin e kapaciteteve për menaxhimin efektiv të ligatinave.

Aktivitetet kryesore në 2024:

- Pjesëmarrja në një seminar dy-ditor për zhvillimin e kapaciteteve mbi kontratat e ligatinave në Sevilje.
- Kontributi në një ekspozitë që prezanton histori të suksesshme të kontratave të ligatinave në të gjithë Europën.
- Ndërgjegjësim dhe angazhim i palëve të interesuara në nivel kombëtar në Shqipëri, me fokus në peizazhin e mbrojtur Vjosë–Nartë.

Rezultatet:

- Shqipëria, përmes PPNEA-s, është bërë pjesë e një rrjeti mesdhetar të praktikuesve të ligatinave.
- Palët kombëtare të interesuara në Vjosë–Nartë janë njohur me kontratat e ligatinave si një model qeverisjeje.
- Kapacitetet i përmirësuar për menaxhim të integruar të ligatinave në nivel lokal dhe transnacional.

Ndikimi:

WeGOCOOP i ofron Shqipërisë një mjet të provuar europian për qeverisjen e ligatinave, duke nxitur bashkëpunimin në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Kjo forcon mbrojtjen e Vjosë–Nartës, një nga ligatinat më të rëndësishme ekologjike por gjithashtu më të kërcënuarat në vend.



7.5 Ruajtja e fokës së Mesdheut



Vendndodhja:
Bregdeti Jon i Shqipërisë.

Pasqyrë përmbledhëse

Foka e Mesdheut është një nga gjitarët më të rrezikuar të detit në botë, me vetëm disa qindra individë të mbetur. Së fundmi, bregdeti Jon i Shqipërisë është identifikuar si një habitat i rëndësishëm, që ofron shpresë për rikuperimin e këtij lloji. Ky projekt synon të konfirmojë dhe të mbrojë praninë e fokës së Mesdheut, të angazhojë aktorët lokalë dhe të advokojë për masa më të forta të ruajtjes së mjedisit detar.

Objektivat:

- Konfirmimi dhe monitorimi i pranisë së fokës së Mesdheut përgjatë bregdetit shqiptar.
- Mbrojtja e habitateve kritike, përfshirë shpellat detare.
- Angazhimi i peshkatarëve, rojeve bregdetare dhe komunitetit në përpjekjet e ruajtjes.
- Forcimi i kontributit të Shqipërisë në nisma rajonale për ruajtjen e fokës së Mesdheut.



Monitorimi i fokës së Mesdheut

Gjatë vitit 2024, PPNEA zhvilloi aktivitete të rëndësishme monitorimi, ndërgjegjësimi dhe koordinimi, të fokusuar në ruajtjen e fokës së Mesdheut. Kamerat kurth u vendosën brenda shpellave kryesore të bregdetit, ku imazhet nga shpella Dafina konfirmuan praninë e këtij lloji. Rrjeti i monitorimeve të fokës u forcua përmes kontributeve të reja nga aktorët lokalë dhe nëpërmjet shkencës qytetare.

PPNEA mori pjesë gjithashtu në Festivalin e Porto Paler-



Monitorimi i fokës së Mesdheut

mos, duke organizuar pastrimin e plazhit dhe duke shpërndarë materiale edukative për të promovuar turizmin e qëndrueshëm dhe mbrojtjen e habitatit. Një workshop rajonal në Mal të Zi avancoi më tej bashkëpunimin ndërkufitar, duke theksuar shkëmbimin teknik, protokollet standarde të monitorimit dhe qëndrueshmërinë afatgjatë të projektit.

Takimet me stafin e projektit dhe ekspertët ndihmuan në përmirësimin e protokolleve të monitorimit dhe përgatitjen për punën në terren. Me rritjen e presionit nga turizmi, PPNEA planifikon takime të targetuara për operatorët turistikë dhe do të bashkëpunojë me institucione si AdZM Vlorë për të zvogëluar ndërhyrjet në habitatet e fokës. Përpjekjet e ardhshme do të fokusohen në identifikimin e habitateve kritike në Lukovë dhe Krorëz, me qëllim propozimin e krijimit të zonave të reja të mbrojtura detare.



Kamera kurth, PPNEA

7.6 Vendosja e bazave për një të ardhme të qëndrueshme për peizazhin e mbrojtur të Lumi Buna në Shqipëri dhe Grykëderdhjen e Bojanës në Mal të Zi



Lumi Buna



Financimi:
CEPF



Kohëzgjatja:
2 vjet



Partnerët:
EnvPro, Mali i Zi



Vendndodhja:
Lumi Buna (Shqipëri) dhe Grykëderdhja e Bojanës (Mali i Zi)

Prioritetet e Investimit të CEPF të adresuara:

- 2.1 – Përmirësimi i bazës së njohurive mbi biodiversitetin e ujërave të ëmbla: Arritur përmes kërkimeve shkencore mbi llojet e synuara.
- 2.2 – Ulja e kërcënimeve dhe përmirësimi i menaxhimit të vendndodhjeve: Zbatuar përmes veprimeve të konservimit bazuar në analizën e situatës për llojet në rrezik.
- 2.3 – Angazhimi i aktorëve në menaxhimin e integruar të baseneve të lumenjve: Avancuar përmes analizës së situatës, e zhvilluar në bashkëpunim të ngushtë me institucionet menaxhuese.

Përmbledhje

Ky projekt kontribuoi në mënyrë të konsiderueshme në ruajtjen e ekosistemeve të ujërave të ëmbla në sistemin transkufitar Buna-Bojana. Duke kombinuar kërkimin, trajnimin, konservimin, ndërhyrjen ligjore dhe angazhimin e komunitetit, dhe krijoi një bazë të fortë për menaxhimin e qëndrueshëm afatgjatë të këtij habitati kritik.

Aksionet kryesore dhe rezultatet

1. Analiza e situatës dhe raportimi

- U zhvillua monitorim inovativ i popullatave të peshqve, duke kombinuar metoda tradicionale dhe teknikat e ADN-së.
- 31 lloje peshqish u identifikuan përmes analizës ADN.
- Gjetjet mbi shpërndarjen e llojeve dhe kërcënimet u ndanë me aktorët përkatës në Shqipëri dhe në Mal të Zi.

2. Ndërtimi i kapaciteteve

- U organizuan seanca të strukturuar trajnimi për autoritetet në Shqipëri dhe Mal të Zi mbi ekosistemet e ujërave të ëmbla, metodologjitë e monitorimit të peshqve, protokollat dhe direktivat e BE-së.
- 47 pjesëmarrës u bënë pjesë e këtij trajnimi, duke forcuar kapacitetin institucional dhe teknik për menaxhimin e ujërave të ëmbla.



Analiza e ADN-së në lumin Buna për Blinin e bardhë (*Acipenser naccarii*), një lloj peshku

3. Aksione për konservim

- **Aksion Pastrimi:** Në bashkëpunim me AdZM, FMO, Bashkinë e Shkodrës, shkolla dhe aktorë të tjerë, u organizua një aktivitet pastrimi i bregut.
 - U inspektuan 10 km bregdet (30 ha).
 - Rrjetat e vjetra të peshkimit u mblodhën dhe u larguan me varka.
- **Veprime ligjore:**
 - Nisi vlerësimi ligjor për zhvillimet infrastrukturore si gurorët në lumenj dhe barrierat metalike. Pas kësaj, një memorandum dhe raport mjedisor do t'i dorëzohen institucioneve përkatëse në shkurt 2025 për inspektim dhe zbatim në terren.
- **Patrullime:** U zhvilluan patrullime të shumta në zonë për të regjistruar dhe raportuar aktivitetet e paligjshme, duke siguruar referim të menjëhershëm te autoritetet përkatëse.



Aksion pastrimi dhe heqje e rrjetave të vjetra/braktisura të peshkimit, në Liqenin e Shkodrës dhe lumin Buna

4. Ndërgjegjësim & informim

- **U zhvilluan dhe shpërndanë materiale komunikimi dhe edukimi, duke përfshirë:**
 - video në YouTube që nxjerr në pah aktivitetet e projektit.
 - 100 kalendarë, 200 broshura dhe 100 postera.
- **Materialet u shpërndanë gjerësisht për të rritur ndërgjegjësimin tek shkollat, komuniteti lokal dhe vendimmarrësit.**

Ndikimi

Përmes monitorimit inovativ, bashkëpunimit ndërkufitar dhe veprimeve që synojnë ruajtjen, projekti forcoi bazën e njohurive dhe kapacitetin menaxherial për ekosistemin e lumit Buna–Bojana. Kombinimi i kërkimit shkencor, veprimeve praktike të pastrimit dhe ndërhyrjeve ligjore jo vetëm që adresoi kërcënimet e menjëhershme, por gjithashtu vendosi bazat për mbrojtjen afatgjatë të ekosistemit në Shqipëri dhe Mal të Zi.



Advokim dhe kërkesë ndaj autoriteteve për heqjen e pengesave metalike në lumin Buna

BalkanDetox LIFE – Forcimi i kapaciteteve kombëtare për të luftuar helmimin e jetës së egër dhe për të rritur ndërgjegjësimin në shtatë vende të Ballkanit

Projekti BalkanDetox LIFE (2020–2025) është një nga nismat kryesore që punon për të ndaluar helmimin e jetës së egër në Ballkan. Ai synon të forcojë kapacitetet për menaxhimin e rasteve të helmimit, të rrisë ndërgjegjësimin për këtë problem, të përmirësojë bashkëpunimin midis institucioneve dhe të reduktojë incidentet që kërcënojnë jetën e egër, ekosistemet dhe shëndetin publik.

Në vitin 2024, PPNEA përqendroi përpjekjet në veprime konkrete në Shqipëri, duke arritur progres përmes këtyre përparësive kryesore:

- **Përmirësimi i bashkëpunimit institucional**

Në janar, PPNEA kontribuoi në programin kombëtar të trajnimeve për krimet ndaj jetës së egër në Tiranë, i organizuar nga AOS. Së bashku me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, AKZM, prokurorët lokalë, Federatën Kombëtare Shqiptare të Gjuetisë, AdZM dhe institucione të tjera, ekipi ynë ndau përditësime mbi projektin dhe mori pjesë në sesione interaktive që forcuan angazhimin institucional për adresimin e incidenteve të helmimit.

- **Forcimi i lidhjeve me institucionet ligjzbatuese**

Në gusht, PPNEA realizoi një takim me njësinë e Policisë së shtetit për të përmirësuar komunikimin dhe bashkëpunimin në reagimin ndaj krimeve mjedisore. U arrit një marrëveshje për krijimin e kanaleve të drejtpërdrejta për rastet e helmimit ose vrasjeve të paligjshme, me policinë që shfaqi gatishmërinë për

trajnime të përbashkëta në të ardhmen për të rritur kapacitetin e tyre.

- **Forcimi i bashkëpunimit gjyqësor dhe ndër-aktorial**


Në dhjetor, PPNEA mori pjesë në një takim kombëtar që mbledhi prokurorë, gjykatës, policinë e shtetit, grupin e punës kundër helmimit dhe OJF-të. Diskutimet u fokusuan në forcimin e kuadrit ligjor dhe institucional për të siguruar hetim dhe ndëshkim më efektiv të krimeve të helmimit.

- **Rritja e ndërgjegjësimit publik dhe veprime në terren**

PPNEA është kontribues aktiv në bazën e të dhënave për helmimin e jetës së egër me regjistrime të incidenteve të helmimit në Shqipëri. Të dhënat tregojnë se shumica e rasteve ndodhin në zona urbane, kryesisht duke prekur macet e egra dhe qentë. Gjatë vitit 2024, janë zhvilluar vizita të vazhdueshme në terren dhe takime informale me banorët lokal në zonat ku gjendet Kali i qyqes, të cilat konsiderohen kritike për praninë e helmimit.

Në fund të gushtit, një vizitë në terren në territoret e Kalit të qyqes kombinoi monitorimin e llojit me takime dhe diskutime me komunitetet lokale mbi çështje të ndryshme mjedisore, duke ndihmuar në rritjen e ndërgjegjësimit dhe promovimin e masave parandaluese..

Këto veprime gjatë vitit 2024 përfaqësojnë hapa të rëndësishëm në luftën ndaj helmimit të jetës së egër në Shqipëri. Përmes përmirësimit të bashkëpunimit, forcimit të kapaciteteve institucionale, angazhimit të komunitetit lokal dhe forcimit të zbatimit të ligjit, vendi po ndërmerr hapa domethënës për mbrojtjen e biodiversitetit dhe natyrës.



7.8

Rrugë shtegtimi të sigurta për shpendët IKB 3 - Ndalimi i vrasjes së paligjshme të shpendëve në Mesdhe dhe më gjerë.



Vendndodhja:

Shqipëri – Durrës, Gjiri i Lalzit



Kohëzgjatja:

01.01.2024 – 31.12.2025



Partnerët:

EuroNatur, BirdLife International




Financuesi:

EuroNatur

Qëllimi kryesor i projektit Rrugë shtegtimi të sigurta për shpendët IKB 3 - Ndalimi i vrasjes së paligjshme të shpendëve në Mesdhe dhe më gjerë. Veçanërisht në Gjirin e Lalzit, një nga zonat më të rëndësishme për shpendët shtegtues, veçanërisht dimërues. Projekti synon të krijojë një bazë/strukturë ose sistem (zgjidhni) të qëndrueshme dhe afatgjatë kundër gjuetisë së paligjshme, duke promovuar reforma ligjore, angazhimin e komunitetit dhe forcimin e zbatimit të ligjit. Gjatë vitit 2024, fokusi kryesor ishte ulja e incidenteve të gjuetisë së paligjshme në Gjirin e Lalzit, përmirësimin e grumbullimit të të dhënave dhe monitorimit si dhe forcimin e mbështetjes së komunitetit në ruajtjen e shpendëve.

Këto objektiva lidhen direkt me misionin e PPNEA-s për të mbrojtur biodiversitetin, për të promovuar politika mjedisore të qëndrueshme dhe për të parandaluar vrasjet e paligjshme të jetës së egër. Përmes bashkëpunimit ndërkombëtar dhe advokimit kombëtar, projekti kontribuon në ruajtjen e rrugëve të shtegtimin të shpendëve dhe integritetin ekologjik të ligatinave në vend.



Perëndim në Fllakë, Gjiri i Lalzit


Veprimet kryesore të PPNEA-s në vitin 2024:

• Hulimtim dhe monitorim:

- U realizuan vizita sistematike në terren (mars-maj) për mbledhjen e të dhënave mbi vrasjet e paligjshme të shpendëve (IKB).
- Bashkëpunuam me gjuetarë të përgjegjshëm, veçanërisht për monitorimin e shkurtëzës (*Coturnix coturnix*).
- Fillimi i monitorimit në bashkëpunim me universitetet dhe komunitetin lokal.

• Seminare me qëllim ndërgjegjësues:

- U organizua një takim në Pogradec me pjesëmarrjen e aktorëve përfshirë OJQ-të, organet e zbatimit të ligjit dhe gjuetarët.
- U organizuan aktivitete si “Dita Botërore e Ligatinave” dhe “Global Big Day” për rritjen e ndërgjegjësimit publik.
- U publikua fushata “Fluturimi për Mbijetesë” dhe “Censusi i Lejlekut” për angazhimin e komunitetit publik në ruajtjen e shpendëve.



Monitorimi i fushezave dhe i gjuetisë së paligjshme në Gjirin e Lalzit

7.9 “SHTEGU I BALLKANIT”



Korniza Kohore:

Nëntor 2023 – Tetor 2024



Financimi: European Green Belt, Bestbelt, me mbështetje financiare nga Bashkimi Evropian



Vendet: Bullgaria, Shqipëria, Serbia, Turqia, Maqedonia e Veriut




Partnerët: BBF (Bullgari), PPNEA (Shqipëri), TEAM (Serbi), Back to Nature (Turqi), Center Ambrozija (Maqedoni e Veriut)

“Shtegu i Ballkanit” është një projekt partneriteti i zhvilluar në vendet e Ballkanit, me qëllim kryesor forcimin, mbështetjen dhe lidhjen e infrastrukturës ekzistuese të shtigjeve përgjatë Brezit të Gjellbër të Ballkanit. Projekti krijon një rrugë shëtitjeje panoramike, të quajtur “Shtegu i Ballkanit”, dhe synon të promovojë vlerat e biodiversitetit të rajonit, duke kontribuar gjithashtu në zhvillimin e qëndrueshëm të komuniteteve lokale. Periudha e zbatimit është nga nëntori 2023 deri në tetor 2024.

Ky projekt përbëhet nga krijimi i një shtegu shëtitjeje prej 3550 km, që do të kalojë përmes Hungarisë, Serbisë, Rumanisë, Bullgarisë, Malit të Zi, Shqipërisë, Maqedonisë së Veriut, Greqisë dhe Turqisë. Zbatimi kryesor do të realizohet nga partnerët: Bulgarian Biodiversity Foundation (Bullgari), PPNEA – Organizata për Ruajtjen dhe Mbrojtjen e Mjedisit Natyror në Shqipëri (Shqipëri), TEAM – Protection and Citizens Association (Serbi), Back to Nature (Turqi), dhe Ambrozija – Center for Medical Herbs and Berries (Maqedonia e Veriut).

Qëllimi kryesor i projektit është të diversifikojë ekonominë rurale dhe të krijojë shtegun si mundësi për role të ndryshme pune, përfshirë guidat në male, vëzhgues shpendësh, edukim mjedisor, infrastrukturë të sigurt për shëtitësit në shpatet malore, dhe nisma të bujqësisë organike.

Si pjesë integrale e Brezit të Gjellbër Evropian (EGB), “Shtegu i Ballkanit” synon të promovojë jetesën e qëndrueshme, ruajtjen e burimeve natyrore, bashkëpunimin ndërkombëtar, dhe edukimin e brezit të ardhshëm.



7.10

Brezi i Gjelbër Evropian – Projektet “Udhërrëfyese” hapin rrugën drejt një të ardhmeje të qëndrueshme në Sharr-Korab-Koritnik dhe më gjerë



© Euronatur



Vendndodhja: Zona Transkufitare Sharr – Korab – Koritnik



Kohëzgjatja:
17 muaj



Partnerët e Projektit: Euronatur; CNVP Kosovo; Shoqata Ekologjike e Maqedonisë



Donatorët e Projektit: AAEG V. Jensen Charity Foundation

Qëllimet dhe rezultatet

• Qëllimet:

- Zgjerimi i modeleve më të suksesshme si projekte “Udhërrëfyese” për zhvillimin rural dhe menaxhimin e zonave të mbrojtura.
- Ngritja e kapaciteteve të Grupeve Lokale të Veprimit (LAG) për të vepruar si aktorë të pavarur dhe për të shumëfishuar përpjekjet në fushën e konservimit dhe zhvillimit të qëndrueshëm.
- Shtirja e punës në rajonin Sharr-Korab-Koritnik dhe identifikimi i mundësive për ripërsëritjen e qasjes.

• Rezultatet:

- 0.1 ha u mbollën me *Gentiana lutea* në Novosejë, Kukës.
- Forcimi i bashkëpunimit transkufitar mes Grupeve Lokale të Veprimit.
- Prezantimi i projekteve model ndërmjet aktorëve të ndryshëm të përfshirë.

Aktivitetet Kryesore:

Festimi i ditëve të Brezit të Gjelbër Evropian në Radomirë

Më 21 shtator në Radomirë, Dibër, PPNEA mori pjesë në festimet e Ditëve të Brezit të Gjelbër Evropian, të organizuara nga OJQ SHERM. Ngjarja bashkoi komunitetin lokal, OJQ-të, bletarët, AdZM Dibër, mësuesit dhe nxënësit. Programi përfshiu një sesion informues mbi Brezin e Gjelbër, një shëtitje drejt “Liqenit të Zi,” diskutime dhe një drekë të përbashkët në natyrë. PPNEA kontribuoi duke shpërndarë manuale mbi bimët medicinale, pako me bimë dhe mjaltë lokal nga Kosova.

Mbjellja e *Gentiana lutea*

Në tetor 2024, PPNEA, në bashkëpunim me drejtorin e MMZHT, Jahir Cahani, dhe fermerët lokalë, mbështeti mbjelljen e bimës së rrallë medicinale *Gentiana lutea* në 0.1 hektar në Novosejë, Kukës.



Mbjellja e *Gentiana lutea*

Shkëmbimi midis Grupit Lokal të Veprimit Vjona dhe atij Korab-Koritnik

Më 1–2 nëntor 2024, PPNEA organizoi një shkëmbim midis **Grupit Lokal të Veprimit Korab–Koritnik** dhe Grupit Lokal të Veprimit Vjona, në Peshkopi, me 27 pjesëmarrës përfaqësues autoritetet lokale. Takimi u fokusua në ndarjen e përvojave mbi zhvillimin e Grupeve Lokale të Veprimit dhe sfidat e regjistrimit. Pjesëmarrësit nga Vlora eksploruan edhe trashëgiminë kulturore të Dibrës përmes prodhimit tradicional të “jufkës.” Programi përfshiu vizita në një fabrikë lëngu mollësh si model i zhvillimit ekonomik lokal dhe një ekskursion nëpër **Silovë** dhe **Radomirë**, duke theksuar rëndësinë ekologjike të Luginës së Drinit të Zi dhe vendet e trashëgimisë kulturore. Në Radomirë u prezantua metodologjia **Transect Walk**, duke angazhuar komunitetin në identifikimin e vlerave natyrore, praktikave dhe kërcënimeve, si sëmundjet e pyjeve, praninë e ariut, mungesën e mbështetjes nga qeveria dhe emigrimin e të rinjve.

Konferenca Pan-Evropiane Bestbelt, Jurmala, Letoni

Më 14–18 tetor në **Jurmala, Letoni**, përfaqësues të PPNEA, Ekologët për Rajonin dhe GLV Integrimi, morën pjesë në një konferencë, duke përfaqësuar edhe **Grupit Lokal të Veprimit Korab–Koritnik**. Takimi ofroi mundësi për shkëmbim me partnerët e Brezit të Gjelbër, njohje me projektet Bestbelt dhe vizita në tre zona projektsh që tregojnë praktika konservimi të aplikueshme për livadhet shqiptare. Janë prezantuar 13 projekte model nga nisma **Sharr–Korab–Koritnik (2021–2023)**, dhe PPNEA mori pjesë gjithashtu në **Asamblenë e Brezit të Gjelbër Evropian** më 17 tetor.

Projekti arriti të bashkonte me sukses tre Grupet Lokale të Veprimit nga vendet transkufitare për të krijuar një vizion të përbashkët për të ardhmen e zonës Sharr–Korab–Koritnik.

Mësimet e nxjerra dhe hapat e ardhshëm:

- Kërkohet më shumë punë dhe përpjekje për bashkëpunim ndërkufitar në aktivitetet e përbashkëta të ardhshme.
- Nevojiten më shumë përpjekje dhe fonde për ruajtjen e bimëve mjekësore dhe promovimin e nismave të tyre.



Radomirë



7.11

Nga Foleja në Det: Mbrojtja e breshkave të detit, në Shqipëri



Periudha e Zbatimit:

2024 – ongoing



Financimi:

Rufford Foundation



Vendi:

Shqipëri

Puna e kryer nga PPNEA për mbrojtjen e breshkave të detit ka luajtur një rol të rëndësishëm në ruajtjen e këtyre llojeve të lashta dhe të rrezikuara. Breshkat e detit janë ndër llojet më të vjetra në planet dhe i përkasin rendit Testudines. Në botë ekzistojnë shtatë lloje breshka deti, nga të cilat gjashtë i përkasin familjes Cheloniidae, ndërsa vetëm Breshka kurrizlëkurore (*Dermochelys coriacea*) i përket familjes Dermochelyidae.

Në Shqipëri janë regjistruar tre lloje breshka të detit përgjatë bregdetit Jon dhe Adriatik: breshka kokëmadhe e detit (*Caretta caretta*), Breshka e gjelbër (*Chelonia mydas*), dhe kurrizlëkurore (*Dermochelys coriacea*) e cila është shumë e rrallë dhe është vërejtur vetëm në disa raste të izoluar.

Studimet mbi folezimin e breshkave të detit në Shqipëri kanë qenë të kufizuara, me kërkime të rëndësishme që kanë filluar në vitin 2002. Pas kësaj periudhe, janë regjistruar disa raste sporadike folezimi në zonat e Kepit të Rodonit dhe Divjakës. Në vitet e fundit, është realizuar një studim për të identifikuar vendet e mundshme të folezimit dhe për të zhvilluar masa mbrojtëse për rastet sporadike të gjetura në Shqipëri. Gjatë këtij studimi, janë identifikuar disa plazhe të përshtatshme për folezimin e breshkave të detit.

Breshkat e detit kalojnë pjesën më të madhe të jetës së tyre në det dhe dalin në breg vetëm gjatë periudhës riprodhuese për të hedhur vezët. Suksesi i tyre riprod-



Monitorimi i breshkave të detit në Peizazhin e Mbrojtur Vjosë - Nartë

hues varet kryesisht nga ruajtja e habitateve të folezimit, masat mbrojtëse dhe ndikimet e ndryshimeve klimatike, pasi rritja e temperaturave mund të ndikojë në gjininë e vezëve dhe të rrezikojë mbijetesën e llojeve.

Përpjekjet e PPNEA për mbrojtjen e breshkave të detit janë intensifikuar vitet e fundit, duke përfshirë monitorimin e vendeve potenciale të folezimit përgjatë bregdetit shqiptar. Gjatë tre viteve të fundit, ekipi i PPNEA ka mbledhur të dhëna mbi shpërndarjen, kërcënimet dhe modelet riprodhuese të këtyre breshkave. Megjithatë këto të dhëna nuk janë publikuar ende, në vitet e mëparshme janë identifikuar gjashtë fole, të cilat të gjitha u shkatërruan nga presione natyrore dhe antropogjene, si predatorët, valët dhe ndërhyrjet e njeriut.

Një arritje e rëndësishme ishte sezoni i parë i suksesshëm i folezimit të breshkave të detit në rajonin e Vlorës, ku midis qershorit dhe shtatorit 2024, 4 nga 7 fole rezultuan të suksesshme. Ky është një hap i rëndësishëm për ruajtjen e këtyre llojeve dhe konsiderohet një arritje kryesore, duke treguar rritje të numrit të foleve dhe përmirësim të suksesit të daljes së të vegjëlve. Ky sukses u mundësua falë



Monitorimi i breshkave të detit në Peizazhin e Mbrojtur Vjosë - Nartë

masave mbrojtëse dhe menaxhimit të habitatit të zbatuar gjatë këtij sezoni.

Viti 2024 shënoi gjithashtu përpjekjen e parë të Shqipërisë për zhvendosjen e vezëve të breshkave të detit, e cila u realizua me sukses me mbështetjen e Rufford Foundation. Ky zhvillim tregon se zhvendosja e vezëve mund të jetë një strategji efektive për mbrojtjen e foleve të rrezikuara dhe ofron mundësi të reja për përpjekjet konservuese. Ky sukses do të përfshihet në një artikull shkencor, që do të ofrojë udhëzime të vryera për ndërhyrje të ardhshme në Shqipëri dhe rajon.

Një element i rëndësishëm që duhet theksuar në kontekstin e studimeve mbi folezimin e breshkave të detit në Shqipëri është përdorimi i plazheve jugore me gurore për hedhjen e vezëve. Ky fakt ka qenë objekt i rëndësishëm hulumtimi, pasi tradicionalisht breshkat zgjedhin plazhe me rrërë për folezim, ndërsa plazhet me gurore nuk konsideroheshin gjithmonë të përshtatshme për zhvillimin e vezëve. Një shembull i qartë është plazhi i Palasës, ku në vitin 2021 disa anëtarë të stafit të PPNEA panë një Breshkë kokëmadhe të detit (*Caretta caretta*) duke hedhur vezët, dhe në vitin 2024 u vërejt dalja e suksesshme e të vegjëlve në këtë zonë, duke shënuar një pikë kthese në kuptimin tonë mbi mundësinë e folezimit në plazhe me gurore.

Nga pikëpamja shkencore, folezimi në plazhe me gurore mund të ofrojë disa përfitime për breshkat e detit. Gurëzimi mund të jetë më i qëndrueshëm dhe më pak i ndjeshëm ndaj erozionit nga valët ose baticat, të cilat shpesh dëmtojnë foletë në plazhet me rrërë. Gjithashtu, nivelet e përmbajtjeve në plazhet me gurore mund të jenë më të ulëta, duke siguruar një habitat më të sigurt për inkubimin e vezëve. Kjo mund të shpjegojë pse breshkat, edhe pse zakonisht preferojnë plazhet me rrërë, mund të adaptohen edhe në struktura të tjera, si ato me gurë, kur ato ofrojnë kushte të favorshme për zhvillimin e vezëve dhe mbrojtjen e foleve.

Me monitorim të vazhdueshëm, masa të nevojshme mbrojtëse dhe angazhimit të komunitetit lokal, PPNEA synon të kontribuojë në mbrojtjen afatgjatë të breshkave



Monitorimi i breshkave të detit në Peizazhin e Mbrojtur Vjosë - Nartë



Monitorimi i breshkave të detit në Peizazhin e Mbrojtur Vjosë - Nartë

të detit dhe të sigurojë një të ardhme më të sigurt për këto lloje të rrezikuara.

Një vit rekord për breshkat e detit në Shqipëri

Sezoni i folezimit 2024 shënoi një pikë kthese për konservimin e breshkave të detit përgjatë bregdetit Adriatik dhe Jon të Shqipërisë. Për herë të parë, Breshka kokëmadhe e detit (*Caretta caretta*) shfaqën një rritje të dukshme si në numrin e foleve ashtu edhe në suksesin e daljes së të vegjëlve, ku katër fole në Peizazhin e Mbrojtur Pishë-Poro-Narta lindën të vegjël të shëndetshëm që arritën të sigurt në det. Edhe në brigjet shkëmbore të bregdetit Jon, breshkat treguan aftësinë e tyre për t'u përshtatur, duke hedhur vezët dhe duke siguruar mbijetesën e gjeneratës së ardhshme.

Ky sukses reflekton përpjekjet e vazhdueshme të PPNEA, në bashkëpunim me Rufford Foundation, AdZM Vlorë dhe ekspertë lokalë e ndërkombëtarë. Një arritje e rëndësishme ishte realizimi i parë në Shqipëri i zhvendosjes së foleve në zonat me rrezik të lartë, një metodë efektive që mbrojtë vezët e ndjeshme nga valët dhe predatorët, duke siguruar shkallë më të lartë mbijetese.

Pas më shumë se 55 ditëve ngrohje të vezëve ose inkubim, të vegjëlit nisën udhëtimin e tyre të mesnatës drejt detit, të udhëhequr nga instinkti dhe shkëlqimi i valëve. Këta hapa të vegjël përfaqësojnë si qendrueshmërinë, ashtu edhe shpresën, pasi një ditë breshkat do të kthehen në të njëjtat brigje për të hedhur vezët.

Mbrojtja e habitateve të ndjeshme të brigjeve Jon dhe Adriatik është thelbësor, jo vetëm për breshkat e detit, por për të gjithë ekosistemin detar. Arritjet e këtij viti tregojnë se me shkencë, angazhim dhe bashkëpunim, bregdeti i Shqipërisë mund të vazhdojë të jetë një strehë e sigurt për këta udhëtarë të lashtë të deteve.

Numërimi i shpendëve shtegtarë në Peizazhin e Mbrojtur Vjosë - Nartë



KAPITULLI




8

LIDHU, MBËSHTET, DHE ANGAZHOHU


Komunikimi dhe
financat



8.1 Angazhimi në Platforma të Ndryshme



8.2 Rezultatet 2024 - PPNEA



8.3 Raporti Financiar për Vitin 2024



Të ardhura totale,
marrëveshje grantesh

688,555 €



Të ardhura totale,
kontrata ekspertize

31.420 €



Kosto
të stafit

357,325 €



Shërbime për aktivitete
dhe projekte

363,140 €

8.4 Mbrojtja e natyrës nuk është një detyrë e lehtë!

Kërkon kohë, përkushtim, pasion dhe qëndrueshmëri.

Kontributi juaj financiar mund të jetë një ndihmë e madhe për ne në punën tonë për mbrojtjen dhe ruajtjen e së ardhmes së mjedisit natyror në Shqipëri.

Çdo ndihmë, sado e vogël, është e çmuar dhe na mundëson të ndërmarrim hapa më të fortë për të mbrojtur llojet dhe habitatet e rrezikuara.

Faleminderit nga zemra që po bëni një ndryshim në mbrojtjen e natyrës!

8.5 Bëhu vullnetar: Bashkohu me përpjekjet tona

Bëhu Vullnetar – Ndihmo natyrën duke gjetur një rol brenda PPNEA-s

Si vullnetar i PPNEA-s, koha, talenti dhe aftësitë tuaja ndihmojnë në ruajtjen e biodiversitetit në Shqipëri! Përfshirja juaj mund të mbështesë zgjerimin e projekteve ekzistuese dhe zhvillimin e nismave të reja. Kontributi i vullnetarëve tanë është thelbësor për suksesin e organizatës.

Vullnetarizmi sjell entuziazëm, aftësi dhe interesa të reja, ndërsa ju vetë mësoni dhe zbuloni aftësi të tjera. Detyrat praktike mund të përfshijnë vrojtimin e jetës së egër, aktivitete të ndryshme konservimi, organizimin e shëtitjeve ose ekskursioneve për publikun dhe ndihmën ndaj vizitorëve për të shijuar natyrën e mrekullueshme shqiptare.

Kjo është një mundësi e shkëlqyer për të përjetuar natyrën nga një këndvështrim i ri dhe për të kontribuar në diçka që ju vlerësoni. Nëse keni pak kohë, pavarësisht angazhimit, dhe dëshironi të ndihmoni, konsiderojeni veten pjesë të ekipit tonë!

Vullnetarizimi është zëri i njerëzve që shndërrohet në veprim. Këto veprime formësojnë dhe modelojnë të tashmen drejt një të ardhmeje, për të cilën të gjithë mund të jemi krenarë!

~Helen Dyer



Kodi QR:
Raportet
Vjetore



Dhuroni
me
PayPal



Përfshihu më
shumë



APLIKO TANI

KAPITULLI



NDARJA E HISTORIVE

Histori dhe momente kryesore të punës në terren, kërkimit, arritjeve në mbrojtjen e natyrës, ruajtjes së jetës së egër, angazhimit të komunitetit dhe kontributit shkencor të PPNEA-s.



Bishttundësi i verdhë (*Motacilla flava*)

9.1 PPNEA u bashkua me Aleancën e Mesdheut për Ligatinat

Në vitin 2025, PPNEA u bë anëtare e **Aleancës së Mesdheut për Ligatinat**, duke forcuar angazhimin e Shqipërisë për mbrojtjen e ligatinave dhe duke rritur rolin e saj në nismat rajonale dhe ndërkombëtare. Aleanca përbëhet nga një rrjet i fuqishëm me 30 organizata kryesore të mbrojtjes së natyrës dhe institucione kërkimore nga 18 vende, duke ofruar mbështetje, shkëmbim njohurish dhe advokim për mbrojtjen, restaurimin dhe menaxhimin e qëndrueshëm të ligatinave dhe lumenjve të Mesdheut.

Përmes kësaj bashkëpunimi, PPNEA përfiton qasje në teknika të avancuara restaurimi, mjete për monitorimin e biodiversitetit, programe ndërtimi kapacitetsh, si dhe një platformë për bashkëpunim me shoqërinë civile dhe institucionet shkencore. Ky partneritet mbështet mbrojtjen e ligatinave kyçe të Shqipërisë, duke përfshirë **Vjosë-Nartën, Divjakë-Karavastanë dhe Liqenet e Prespës**, duke ndihmuar në ruajtjen e biodiversitetit, rregullimin e klimës dhe shërbimeve jetësore për komunitetet lokale.




9.2 Turtulli afrikan, lloj i ri për Shqipërinë

Turtulli afrikan (*Spilopelia senegalensis*) është një lloj i zakonshëm në Afrikën Subsahariane, Lindjen e Mesme dhe Azinë jugore. Ai mund të gjendet në zona të thata ose gjysmë të thata, si shkretëtira, por një pjesë e popullatës së tij globale gjendet e shpërndarë në fshatra apo edhe qytete të mëdha. Në dy dekadat e fundit ai është përhapur drejt veriut dhe folezon kryesisht në Ishujt Kanarie, Itali në ishullin e Pantelleria, Qipro dhe Greqi.

Ekipi ynë arriti të dokumentojë 3 individë të këtij lloji në qytetin e Fierit, duke bërë të mundur tashmë përfshirjen e Shqipërisë në hartën e tij të shpërndarjes.

Informacioni për praninë e mundshme të turtullit afrikan u dha nga një dashamirës i natyrës, Armando Doda, i cili është dhe pjesë e komunitetit të gjuetarëve në Shqipëri. Falenderime të përzemërta për këtë kontribut, i cili shton listën e llojeve të shpendëve të Shqipërisë



Turtulli afrikan (*Spilopelia senegalensis*) në Fier

9.3 Një fole e re për lejlekun në Gjirokastrë

Në pranverë të vitit 2024, lejlekët shtegtarë u kthyen në Shqipëri si pjesë e udhëtimit të tyre të fluturimit për mbijetesë nga Afrika. Kur një çift tentoi të ndërtonte fole mbi linjat të papërshtatshme të energjisë në Dropull të Gjirokastrës, PPNEA njoftoi partnerët vendas dhe OSHEE-në. Më pas u instalua një platformë e sigurt për fole, që u ofroi lejlekëve një vend të sigurt për të rritur të vegjlit e tyre.



Lejleku në folezim (*Ciconia ciconia*)

9.4 Mishngrënësit e mëdhenj në Evropë

Raporti i fundit LCIE, i mandatuar nga Komisioni Evropian mbi shpërndarjen kontinentale të mishngrënësve të mëdhenj dhe vlerësimin e popullatave të tyre, përfaqëson një kontribut të rëndësishëm të përbashkët nga shkencëtarët, duke u përqendruar në pesë lloji të ndryshme në 34 vende.

Ekspertët e PPNEA-s, falë shumë viteve të hulumtimit të tyre mbi mishngrënësit e mëdhenj në Shqipëri, veçanërisht mbi rrëqebullin dhe ariun e murrme, kanë kontribuar në përgatitjen e raportit për vendin tonë.

Publikimi bazohet në të dhënat më të fundit (2017–2022/23) dhe përfshin lloje që gjenden në Shqipëri, të tilla si ariu i murrme (*Ursus arctos*), rrëqebulli i ballkanit (*Lynx lynx balcanicus*), ujku (*Canis lupus*) dhe çakalli (*Canis aureus*).



**Lexoni artikullin
Kodi QR**

9.5 Statusi i mbrojtjes së ujkut nuk do të jetë më i njëjtë

Komiteti i Përhershëm i Konventës së Bernës miratoi kërkesën e Komisionit European për uljen e statusit të mbrojtjes së ujkut, duke e transferuar atë nga Aneksi II (lloje të mbrojtura në mënyrë strikte) në Aneksin III (lloje të mbrojtura). Ky vendim përfaqësoi një hap të kontestuar nga komuniteti shkencor dhe ekspertët e ruajtjes së natyrës në nivel european, pasi u konsiderua si një devijim nga qasjet e deritanishme të bazuara në evidencë shkencore.

Vendimi ngriti shqetësime lidhur me ndikimin e mundshëm në përpjekjet afatgjata për ruajtjen e ujkut dhe rimëkëmbjen e popullatave të tij në Europë. Në këtë proces, Shqipëria shprehu votën kundër ndryshimit të statusit të mbrojtjes, duke u pozicionuar në përputhje me rekomandimet shkencore për ruajtjen e nivelit ekzistues të mbrojtjes. Edhe pse ky qëndrim, së bashku me atë të disa vendeve të tjera jo-anëtare të Bashkimit European, nuk ndikoi në rezultatin përfundimtar të votimit, ai pasqyroi angazhimin për ruajtjen e llojit në nivel kombëtar dhe rajonal.

Pavarësisht se legjislacioni kombëtar vazhdon të ketë përparësi në zbatimin e masave të mbrojtjes, ndryshime të tilla në kuadrin ndërkombëtar u vlerësuan si potencialisht problematike për popullatat europiane të ujkut. Duke qenë se ujku, ashtu si edhe mishngrënësit e mëdhenj në përgjithësi, kërkon territore të gjera për riprodhim, ruajtja e tij varet ndjeshëm nga bashkëpunimi ndërkufitar. Ulja e statusit të mbrojtjes u konsiderua se mund të kishte pasoja jo vetëm për popullatat brenda kufijve të Bashkimit European, por edhe për ato që shtrihen në territore të përbashkëta me vende jo-anëtare, duke ndikuar negativisht në përpjekjet kombëtare dhe ndërkombëtare për mbrojtjen dhe menaxhimin e këtij lloji.




Ujku (*Canis lupus*)

9.6 Kali i Qyqes “Aoos / Vjosa,” niset drejt Shqipërisë

Kali i Qyqes me emrin Vjosa, nisi shtegtimin e saj nga Afrika, ku kaloi dimrin, drejt vendit të folezimit në Shqipëri. Fillimisht duke fluturuar mbi Çad, Libi, Egjipt, Siri etj, ajo mbërriti në shtëpinë e përhershme, luginën e Vjosës, ku çdo rikthim mirëpritet nga banorët lokalë.

Vjosa nisi shtegtimin në ditën e Verës, duke u bërë tashmë simbol i ardhjes së pranverës në vend.

Udhëtim të mbarë, Vjosa!




Rrugëtimi i kalit të Qyqes dhe lumi Vjosa

9.7 ARTIKULL I RI SHKENCOR MBI ZAKONET USHQIMORE TË ARIUT TË MURRMË (*URSUS ARCTOS*) NË PELLGUN UJËMBLEDHËS NDËRKUFITAR TË PRESPËS

Studimi i nisur në vitin 2018 – 2019, për dietën e ariut të murrmë (*Ursus arctos*) në pellgun ujëmbledhës të Prespës, është publikuar në revistën shkencore Macedonian Journal of Ecology and Environment. Ky studim përfshiu mbledhjen për here të parë të 553 mostrave nga 22 habitate të ndryshme në Shqipëri, Maqedoni dhe Greqi. Rezultatet pasqyrojnë rolin kryesor të bimëve frutore në dietën e ariut, ku kumbullat dhe qershitë (*Prunus cerasifera*) gjenden në gati gjysmën e mostrave.

Barishtet dhe qershitë e egra dominojnë në pranverë dhe mollët e egra në vjeshtë. Në të ardhmen, mbrojtja dhe menaxhimi i popullatës së ariut të murrmë në basenin e Prespës duhet të bazohet më tej mbi dietën kryesore të ariut, gjatë stinëve të ndryshme të vitit si dhe në vlerësimin e habitateve që ai preferon.

Këto rezultate shërbejnë si një gur themeli për të nxitur një bashkëjetesë në harmoni mes njeriut dhe jetës së egër.



Ariu i murrmë, *Ursus arctos*




Lexoni artikullin e plotë - Kodi QR

9.8 Punim i ri shkencor: Statusi dhe kërcënimet për kalin e Qyqes në Shqipëri

Lajme emocionuese, por edhe shqetësuese për kalin e Qyqes në Shqipëri! Gjatë 15 viteve të fundit, një studim gjithëpërfshirës ka zbuluar njohuri thelbësore mbi trendet e popullatës së tyre, parametrat e riprodhimit dhe kërcënimet që i kanosen.

Shqipëria luan një rol kyç në strategjinë më të gjerë për ruajtjen e kalit të Qyqes në Ballkan. Duke zbutur kërcënimet kryesore, duke forcuar bashkëpunimin me institucionet dhe duke miratuar një plan kombëtar veprimi për këtë lloj, ne mund të kontribuojmë në programet rajonale që po punojnë për forcimin e popullatës.



Kali i Qyqes (*Neophron percnopterus*)



Lexoni artikullin e plotë - Kodi QR

9.9 Rritja e rrezikut të zjarreve në pyjet e Shqipërisë: Ndikimi dhe nevoja për reagim të menjëhershëm!

Zjarret në pyje janë kthyer në një problem vjetor pothuajse në të gjitha rajonet e vendit, duke shkatërruar hektarë të tërë pyjesh. Përtej shkatërrimit të menjëhershëm të bimësisë, këto zjarre kanë efekte të thella në jetën e egër, karbonin e sekuestruar dhe biodiversitetin e tokës. Duhet vite për të rivendosur peizazhet e dëmtuara nga zjarret, ku Pashtrik-Morina është një nga ekosistemet më famëkeqe për zjarret në vend. Që nga fillimi i shekullit të 21-të, 177 hektarë pyje janë transformuar për shkak të zjarreve në këtë ekosistem. Zona Pashtrik-Morina, ku po punohet për rivitalizimin e pyjeve, vazhdon të jetë në rrezik të lartë nga zjarret, duke theksuar nevojën e reagimit për parandalimin e zjarreve në pyje.

Ndikimi i zjarreve, i kombinuar me mbikullotjen, prerjet e paligjshme dhe aktivitetet intensive të minierave, sjellin një ndikim final disa here më të rëndë.

PPNEA, me ndihmën e një eksperti të jashtëm GIS, përgatiti dhe publikoi një raport të detajuar të humbjeve të pyjeve vitin e kaluar, duke mbuluar rajonet e Munellës dhe Polis-Gur i Zi-Valamarë nga viti 2016 deri në 2023. Studimi evidentoi ndryshime të rëndësishme të mbulesës pyjore, me humbje të pyjeve duke tejkaluar ritmet e rigjenerimit. Shkaqet kryesore të shpyllëzimit, të identifikuara si prerjet e pyjeve dhe zjarret, kanë prishur ekosistemet lokale dhe habitatet jetës së egër, duke prekur veçanërisht lloje si rrëqebulli i rrezikuar i Ballkanit. Rajonet e Munellës dhe Valamarës kanë pësuar dëmtime të mëdha, me përpjekje të kufizuara ripyllëzimi që kanë rezultuar në ripërtëritje minimale.

Ne duhet të veprojme tani për të vendosur masa parandaluese për të mbrojtur pyjet tona, në vend që të përballemi më vonë me detyrën sfiduese dhe të kushtueshme të pyllëzimit.



Parku Natyror i Munellës

9.10 Dokumentari “Ripërtëritja e Rrënjëve” Rikthimi i Natyrës në Shqipëri

Në Ditën Botërore të Tokës, premiera e dokumentarit “Ripërtëritja e Rrënjëve – Rikthimi i Natyrës në Shqipëri”, realizuar nga Artan Rama, bashkoi entuziastët e natyrës, partnerët, vullnetarët, shkollat dhe palët e interesit për të festuar një angazhim kolektiv ndaj ruajtjes. Dokumentari paraqet një simfoni vizuale, duke treguar histori ripërtëritjeje, përkushtimi dhe përgjegjësie të përbashkët për të mbrojtur ekosistemet e Shqipërisë.

Përmes portreteve tërheqëse, filmi sjell individë, nga vullnetarët që mbjellin fara deri te studentët e rinj që mësojnë të kujdesen për natyrën, duke mishëruar kontrastin midis shkatërrimit dhe mbrojtjes, dhe duke ilustruar se fati i mjedisit tonë varet nga zgjedhjet që bëjmë çdo ditë.

Mbështetur nga BioNET dhe partnerët e përfshirë EuroNatur, Prespa Ohrid Nature Trust (PONT), Aage V. Jensen Naturfond, IUCN Eastern Europe and Central Asia, Heinrich Böll Stiftung Tirana, DIMFE dhe BirdLife Europe & Central Asia, ky projekt pasqyron një përpjekje të përbashkët në të gjithë rajonin. “Ripërtëritja e Rrënjëve” na kujton se restaurimi i natyrës është një udhëtim i përbashkët dhe se çdo veprim, sado i vogël, kontribuon në ripërtëritjen e peizazheve tona. Dokumentari nxjerr në pah si sfidat me të cilat përballemi, ashtu edhe shpresën që lind kur komunitetet bashkohen për të mbrojtur dhe restauruar trashëgiminë natyrore të Shqipërisë.



Dokumentari “Ripërtëritja e Rrënjëve” në Akademinë e Arteve

9.11 Mbi krimet e jetës së egër

Në vitin 2024, PPNEA organizoi një takim në Shqipëri, duke bashkuar zyrtarë qeveritarë, zbatues të ligjit dhe organizata të ruajtjes së natyrës. Fokusi: luftimi i krimeve ndaj jetës së egër, siç është gjuetia e paligjshme e rrëqebullit të Ballkanit dhe ariut të murrmë, dhe helmimi i shpendëve. Takimii forcoi bashkëpunimin, rriti ndërgjegjësimin dhe përgatiti terrenin për veprim të koordinuar.



Mbi krimet e jetës së egër, Pogradec

9.12 RRJETI EMERALD NË BALLKANIN PERËNDIMOR

Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbia janë të detyruara të krijojnë një numër të mjaftueshëm të zonave të Rrjetit Emerald si nënshkruese të Konventës së Bernës. Megjithatë, që nga viti 2011, asnjë zonë e re nuk është propozuar dhe shumë lumenj të mrekullueshëm mbeten të pambrojtur.

Fushata #EmeraldForRivers synon të mbështesë qeveritë në zgjerimin e Rrjetit Emerald.

Fakte kryesore:

- Lumenjtë e Ballkanit janë habitat për 50 lloje peshqish me rëndësi evropiane, asnjë prej të cilave nuk është e mbrojtur në mënyrë të mjaftueshme nga Rrjeti Emerald.
- Deri më sot, vetëm një seminar biogeografik është organizuar për të vlerësuar zonat Emerald në Ballkanin Perëndimor, dhe ai u mbajt që në vitin 2011.
- Gjatë seminarit Emerald Green, 39 shkencëtarë dhe përfaqësues të OJQ-ve nga 11 vende hartuan një listë të hijesuar dhe një hartë me 88 zona potenciale Emerald që duhet të shtohen në rrjet.



#EMERALD for Rivers
(Kodi QR)

Çështjet kryesore:

- I nisur nga Këshilli i Evropës si pjesë e punës së tij në kuadër të Konventës së Bernës, zbatimi i Rrjetit Emerald në nivel kombëtar konsiderohet një nga mjetet kryesore për vendet nënshkruese për të përm-bushur detyrimet e tyre sipas Konventës.
- Ruajtja e lumenjve dhe funksionimi i duhur i Rrjetit Emerald në rajon është një detyrë afatgjatë që kërkon bashkëpunim midis qeverive, shkencëtarëve, OJQ-ve dhe, veçanërisht, komuniteteve lokale që jetojnë brenda ose pranë zonave ekzistuese dhe potenciale të Emerald.
- Gjatë dekadës së fundit, të gjitha vendet e Ballkanit kanë hartuar biodiversitetin e pjesëve të mëdha të ter-ritoreve të tyre si pjesë e përgatitjeve për t'u bashkuar me rrjetin Natura 2000 të BE-së. Përpara se të bëhen zona Natura 2000 si pjesë e anëtarësimit në BE, zonat më të vlefshme duhet të propozohen si zona Emerald.



Në vitin 2024, një koalicion organizatash të shoqërisë civile, përfshirë PPNEA-n, nisi fushatën #EmeraldForRivers, duke i nxitur qeveritë e Ballkanit Perëndimor të forcojnë mbrojtjen e lumenjve të rajonit përmes Rrjetit Emerald, të krijuar nga Këshilli i Evropës në vitin 1989. Fushata përkoi me takimin e 44-të të Komitetit të Përhershëm të Konventës së Bernës në Strasburg, ku u diskutuan objektivat për Rrjetin Emerald deri në vitin 2030. Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbia krijuan Rrjetin Emerald në vitin 2011, por nuk e kanë zgjeruar listën e tyre origjinale të vendeve që atëherë. Shumë lumenj mbeten të pambrojtur për shkak të menaxhimit, monitorimit, njohjes ligjore dhe burimeve të pamjaftueshme.

Fushata bazohet në seminarin Emerald Green (dhjetor 2022), ku shkencëtarët dhe OJQ-të identifikuan 88 vende prioritare lumenjsh që mbështesin mbi 50 lloje peshqish me rëndësi evropiane. Lumenjtë kryesorë të theksuar përfshijnë Vjosën, Drinin e Zi, Neretvën, Bosnjën, Moraçën, Vardarin dhe Danubin, të cilët janë jetikë si për biodiversitetin ashtu edhe për komunitetet lokale. Fushata përfshinte një lançim videoje dhe shtrirje në mediat sociale, duke etiketuar drejtpërdrejt ministrat e mjedisit për të rritur presionin publik dhe qeveritar për mbrojtjen e lumenjve.

Për më shumë informacion ju ftojmë të lexoni:



Video e fushatës:
#EmeraldForRivers (Kodi QR)



Agjenda e takimit të Konventës së
Bernës: 44th Standing Committee
(Kodi QR)



Publikim i Bankwatch:
(Kodi QR)

9.13

Censusi ndërkombëtsr i shpendëve të ujit 2024:

Treguesit nga regjistrimi ndërkombëtar i shpendëve të ujit 2024



Zonat e
mbuluara:

34
ligatina

ligatina të monitoruara më 18-19
Janar 2024.



Numri
total:

99,527
individë

që i përkasin 60 llojeve; rënie
prej 13 % krahasuar me 2023

Ligatinat me popullatat më të larta të shpendëve të ujit:



Parku Kombëtar
Divjakë-Karavasta:

25,473
individë



Liqeni i Shkodrës:

18,416
individë



Peizazhi i Mbrojtur
Vjosë-Nartë:

10,724
individë



Parku Natyror
Kune-Vain-Tale:

10,487
individë



Vështrim mbi ruajtjen e natyrës:

Rënia e numrit të shpendëve të ujit nxjerr në pah nevojën për të forcuar mbrojtjen e ligatinave dhe për të adresuar kërcënimet ndaj habitateve kritike në të gjithë rajonin.



Gjeraqina e shkurtës *Accipiter nisus*



Çafka sqeplugë, *Platalea leucorodia* në Parkun Kombëtar të Butrintit

SMART Balkans – Forcimi i zhvillimit institucional të PPNEA-s



Në vitin 2023, PPNEA arriti një moment të rëndësishëm duke marrë grantin e saj të parë operacional që nga themelimi i saj në vitin 1991. Kjo mbështetje e pakufizuar, e ofruar nga projekti SMART Balkans – Shoqëria Civile për Shoqëri të Përbashkët në Ballkanin Perëndimor, përfaqësoi një pikë kthese në forcimin e kapacitetit të PPNEA-s për t'u përballur me sfidat urgjente të ruajtjes së mjedisit në Shqipëri. Grantet operationale janë thelbësore për organizatat e shoqërisë civile, pasi ato ofrojnë fleksibilitetin për të përmirësuar qeverisjen, për të investuar në planifikim afatgjatë dhe për t'u përgjigjur shpejt kërcënimeve të menjëhershme mjedisore që lindin nga zhvillimi i shpejtë dhe zbatimi i dobët i legjislacionit mjedisor. Viti i parë i zbatimit të kësaj mbështetjeje institucionale në vitin 2024 shënoi një përshpejtim të konsiderueshëm në zhvillimin organizativ të PPNEA-s. Financimi bazë rezultoi jetësor jo vetëm për forcimin e brendshëm, por edhe për veprime me ndikim në terren. Ndër arritjet kryesore ishte bashkëpunimi me POS.al për të hartuar një softuer miqësor ndaj shoqërisë civile për menaxhimin financiar.

Versioni i parë i tij u zhvillua dhe u testua nga PPNEA, me plane për ta prezantuar atë tek OJQ-të e tjera për të lehtësuar operacionet e tyre të përditshme financiare. Në të njëjtën kohë, PPNEA u mobilizua me shpejtësi në përgjigje të njërit prej kërcënimeve më të rëndësishme për Zonat e Mbrojtura të Shqipërisë në vitet e fundit: ndryshimet kontroverze në Ligjin Nr. 81/2017.

Falë mbështetjes institucionale nga SMART Balkans, PPNEA ishte në gjendje të reagoje me vendosmëri duke kundërshtuar ndryshimet në komisionet parlamentare, duke organizuar forume qytetare dhe duke udhëhequr protesta para Parlamentit të Shqipërisë kur u zhvillua votimi.

Projekti SMART Balkans, i financuar nga Ministria Norvegjeze e Punëve të Jashtme dhe i zbatuar nga Qendra për Promovimin e Shoqërisë Civile (CPCD), së bashku me Institutin për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) në Shqipëri dhe Qendrën për Kërkim dhe Hartim Politikash (CRPM) në Maqedoninë e Veriut, kontribuon në forcimin e demokracisë pjesëmarrëse dhe avancimin e integritetit euroatlantik në të gjithë Ballkanin Perëndimor. Duke fuqizuar organizatat dhe rrjetet e shoqërisë civile, kjo nismë ndihmon në ndërtimin e shoqërive paqësore dhe gjithëpërfshirëse dhe siguron zhvillim të qëndrueshëm në Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kosovë, Mal të Zi, Maqedoninë e Veriut dhe Serbi.



PPNEA në takimin e partneritetit Evropian në Almaty

Më 16–17 tetor 2024, PPNEA iu bashkua partnerëve të BirdLife nga e gjithë Europa në takimin e partneritetit Evropian, i organizuar në Almaty nga partneri lokal i BirdLife, ACBK. Ky takim i rëndësishëm bashkoi rrjetin për të reflektuar mbi arritjet që nga viti 2022, për të rishikuar planin e punës dhe financimet për 2024, si dhe për të vendosur prioritetet e përbashkëta për vitet 2025–2026.

Takimi vendosi një theks të fortë mbi turrjen e hapësirës për shoqërinë civile, rritjen e dezinformimit, dhe presionet politike dhe mjedisore në rritje të nxitura nga lëvizjet ekstremiste të djathta në rajon dhe globalisht. Diskutimet u fokusuan në formësimin e përgjigjeve të koordinuara ndaj këtyre sfidave, duke ripohuar rolin e partnerëve të BirdLife në mbrojtjen e natyrës dhe pjesëmarrjes qytetare.

Partnerët gjithashtu eksploruan korniza strategjike të reja për rrugët e shtegimit Afrikë-Evropë-Azi (EAFI, CAFI dhe EAEF), ripanë progresin e nismës RENATE (Rikuperimi i Natyrës në Lindje), dhe vlerësuan punën e Grupit të Punës për restaurimin e natyrës. Këto diskutime nxorën në pah mundësi kyçe për restaurimin e ekosistemeve dhe mbrojtjen e biodiversitetit në të gjithë rajonin.

Një tjetër temë qendrore ishte zhvillimi i strategjive për të mbështetur zgjerimin e energjisë së rinovueshme, veçanërisht energjinë e erës dhe diellit, duke siguruar zgjidhje miqësore me natyrën. Udhëheqja e BirdLife në drejtimin e këtij tranzicioni nënvizoi rëndësinë e organizatave të konservimit në formësimin e një të ardhmeje të qëndrueshme energjetike.

Për PPNEA-n, pjesëmarrja në këtë takim forcoi angazhimin tonë për të kontribuar në mënyrë aktive në strategjitë rajonale dhe globale të konservimit, duke siguruar gjithashtu që prioritetet dhe sfidat e Shqipërisë të përfaqësohen në këto diskutime në nivel të lartë. Forcimi i partneriteteve përmes BirdLife mbetet një gur themeli i misionit tonë për të mbrojtur biodiversitetin dhe për të promovuar një të ardhme të qëndrueshme në Ballkanin Perëndimor dhe më gjerë.



KAPITULLI

10

**ÇFARË
MBAN E
ARDHMJA**







Zvërnec, 2024

10.1

Një vit pas alarmit: Mbrojtja e Zonave të Mbrojtura

Në vitin 2024, PPNEA ndezi alarmin për kërcënimet që po afroreshin ndaj Lumit Vjosa, duke parashikuar pasoja serioze për zonat e mbrojtura të Shqipërisë. Sot, shumë nga ato frikëra janë bërë realitet. Pavarësisht se është shpallur Park Kombëtar, ndryshimet e fundit ligjore tashmë lejojnë ndërtimin e infrastrukturave të mëdha, brenda këtyre ekosistemeve kritike, duke i lënë ata të cenueshme ndaj dëmeve të pakthyeshme.

Konventa e Bern-ës ndërhyri për të ndaluar projektin e aeroportit të Vlorës, duke theksuar pamjaftueshmërinë e masave ekzistuese të mbrojtjes dhe shqetësimet e komunitetit lokal. Megjithatë, veprimet e qeverisë vazhdojnë, me propagandë që mbështet zhvillimin dhe shfaqjen e kërcënimeve të reja.

Ndikimet kryesore të këtyre vendimeve përfshijnë:

- Zgjerimin e aktiviteteve të lejuara në peizazhet e mbrojtura.
- Heqjen e zonimit të brendshëm, që do të thotë se edhe zonat më të ndjeshme ekologjikisht tani janë në rrezik.
- Kërcënime ndaj biodiversitetit, përfshirë habitatet për breshkat e detit, shpendët dhe gjitarët, që tani po përballen me rrezikun e humbjes së përhershme.

Pavarësisht shqetësimit publik dhe sfidave ligjore, vendimet e fundit kanë injoruar këshillat e Bashkimit Evropian, shoqërisë civile dhe mandatet kushtetuese, duke prioritetizuar interesat ekonomike afatshkurtra mbi mbrojtjen afatgjatë të natyrës.

Komiteti i Përhershëm i Konventës së Bern-ës ka nxitur Shqipërinë të rishikojë menjëherë këto vendime, duke riafirmuar nevojën për menaxhim të qëndrueshëm të zonave të mbrojtura në përputhje me standardet evropiane.



Pamje nga Zvërneci ku është propozuar resort me 5 yje, brenda Zonës së Mbrojtur



Peizazhi i Mbrojtur Vjosë - Nartë

Ky raport vjetor është një moment reflektimi: ai shënon jo vetëm fillimin e rritjes së presioneve mbi zonat e mbrojtura të Shqipërisë, por edhe përgjegjësinë e vazhdueshme të shoqërisë civile, autoriteteve dhe qytetarëve për të mbrojtur këto ekosisteme të pazëvendësueshme.

STAFI I PPNEAs

POLITIKA ADVOKUESE DHE RESTAURIMI

Zydjon Vorpsi

Programi i Ruajtjes së Shpendëve

Xhemal Xherri

Programi i Ruajtjes së Shpendëve

Ledi Selgjakaj

Programi i Ruajtjes së Shpendëve

Klejn Ngraçani

Menaxher Projekti

EDUKIMI DHE KOMUNIKIMI PËR RUAJTJEN E NATYRËS

Lorena Pyze Xhafaj

Menaxhere e Komunikimit dhe
Marrëdhënieve me Publikun

Redon Hasanllari

Asistent Projekti

MBËSHTETËS

Dea Zyruku

Ornitologe

Cveta Trajçe

Specialiste e
Gjenerimit të Fondeve

Olsion Lama

Specialist i Gjenerimit
të Fondeve

Sabina Çano

Biologe

BORDI I PPNEA

Ajola Mesiti

Enerit Saçdanaku

Erjola Keçi

Kujtim Mersini

Alba Brojka

Roland Lleshi

Spartak Koçi

DREJTOR EKZEKUTIV

Aleksandër Trajçe

Drejtor ekzekutiv

MENAXHIMI DHE ADMINISTRIMI

Eljona Pujo

Menaxhere Operacionale

Kejsi Haxhiraj

Financiere

RUAJTJA E NATYRËS DHE KORRIDORET EKOLOGJIKE

Klaudja Koçi

Menaxhere Programi

Emir Gjyzeli

Ekspert GIS

Bledi Hoxha

Programi i Ruajtjes së
Gjitarëve

Ilir Shyti

Programi i Ruajtjes së
Gjitarëve

Melitjan Nezaj

Programi i Ruajtjes së
Gjitarëve

Marina Xhaho

Programi i Ruajtjes së
Gjitarëve

ZYRA VENDORE TË PPNEA

Kostandin Xhaho

Oficer Vendor, Vlorë

Tina Donefski

Koordinator e Zyrës
Vendore, Prespë

Adnand Bego

Asistent në Zyrën
Vendore, Prespë

Kristi Gjoni

Specialist Projekti, në
Zyrën Vendore, Prespë





PPNEA

RAPORT
VJETOR

20
24



ppnea.org

